



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional

Master Profesional "Komunikim Publik"

i Institucionit të Arsimit të Lartë

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Doc.dr. Ramadan Çipuri

2. Dr. Erlis Çela

Qershor, 2020

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Përshkrim përmbledhës 200 - 400 fjalë

Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim Publik”, si strukturë e Departamentit të Shkencave Politike në Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës, UAMD, ka nisur të zbatohet në vitin akademik 2018-2019.



Ky program studimi synon të aftësojë studentët në studimin e thelluar të teorive dhe modeleve bashkëkohore të komunikimit, të ndara sipas disa prej fushave kryesore të zbatimit të tyre në politikë, në shoqërinë civile, biznes etj. Masteri, synon gjithashtu, të përgatisë ekspertë komunikimi të aftë për t’u angazhuar në menaxhimin e marrëdhënieve publike në sektorë të ndryshëm. Theks i veçantë i vihet forcimit të aftësive konkrete profesionale përmes studimit të strategjive bashkëkohore, si dhe modeleve më të suksesshme të komunikimit publik.

Programi Master Profesional në “Komunikim Publik” ofron njohuri të mira në fushën e komunikimit duke rritur mundësitë për karrierë profesionale. Sektorët e mundshëm të punësimit për profilin e studimit në Marrëdhënie me Publikun janë sektori publik dhe ai privat, si ministritë, institucione të tjera të linjës, bashki, institucione të tjera publike, etj., apo edhe në organizata të ndryshme joqeveritare, organizata ndërqeveritare, agjenci, seli të prezencës së institucioneve të huaja në vend, organizata joqeveritare rajonale, etj.

Pas përfundimit të programit, të diplomuarit kanë mundësi të përshtaten dhe të kontribuojnë në tregun e punës, të realizojnë produkte dhe shërbime në redaksitë audio dhe audiovizive, në njësi të PR-it, të bëhen pjesë ose të menaxhojnë fushata promovuese, informuese e ndërjegjësuere, si dhe në sektorë të ndryshëm të medias dhe komunikimit.

Hapja e këtij programi të ciklit të dytë me kohë të plotë të studimeve bazohet në Urdhrin nr. 652, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, datë 11.10.2018, ka 60 kredite ECTS dhe zgjat 1 vit akademik.

Ky procesi akreditimi është i pari që ndodh në lidhje me këtë program.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i programit të studimit “Master Profesional “Komunikim Publik” në UAMD nisi punën për vlerësimin duke u njohur fillimisht me materialet dokumentare të vendosur në sistemin e ASCAL. Koordinator i programit ndau përmes platformës dokumentet e nevojshme thujse për të gjitha pikat që vlerësohen në program, me një numër shumë zgjeruar eciencash.

Nën koordinimin e ekspertës së caktuar nga ASCAL, u planifikua vizita në institucion në datat 2-3 mars 200. Gjatë vizitës u realizuan takimet me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të raportit të paraqitur, me pedagogë të Departamentit të Shkencave Politike, studentë dhe të diplomuar nga ky program, përfaqësues të Zyrës së Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, përfaqësues të sektorit të Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve dhe përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, punonjësit e sekretarisë mësimore, si edhe u vizituan mjediset universitare, përfshi këtu edhe bibliotekën.


Gjatë vizitës u kërkua informacion shtesë i cili u plotësua dhe u vendos në faqen e ASCAL.

Duhet theksuar fakti se i gjithë stafi me të cilin zhvilluam takime ishin të gatshëm për t’iu përgjigjur pyetjeve të lindura gjatë procesit të hulumtimit të dokumentacionit të paraqitur, si edhe dorëzimit në kohë të evidencave shtesë të kërkuara gjatë vizitës në institucion.

Koordinatorë Teknikë e ASCAL është Znj. Aviola Bardhi.

Më datë 09.06.2020, përmes sistemit AMS, UAMD është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm dhe me shkresë Nr. Prot, 4/55, datë 09.06.2020. Më datë 26.06.2020, UAMD përcjell shkresën me Nr. Prot, 686/1, datë 26.06.2020 me të cilën shpreh dakordësinë me përmbajtjen e tij.

Draft- Raporti kthehet në Raport përfundimtar.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Komunikim Publik”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Pas një vlerësimi të detajuar që iu bë raportit të vlerësimit të brendshëm, por edhe shumë prej evidencave të paraqitura që tregojnë mënyrën e organizimit institucional, vizionin dhe misionin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” (Durrës) si Statuti i ri, Plani i Zhvillimit Strategjik 2016-2020, Kodi i Etikës të UAMD-së, Rregullorja e re e UAMD-së etj., rezulton se UAMD ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Neni 3/d i statutit të UAMD thekson se ky institucion synon “... të përgatisë profesionistë dhe qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe vlerat evropiane.”
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar Statutit të institucionit, UAMD ofron programe studimi të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Ato bazohen në “... vlerësimin e nevojave duke ndjekur dinamikën e tregut të punës”.
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Në deklaratën e qëllimit të UAMD Neni 4 theksohet se UAMD ka qëllim “... zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor për rritjen e mirëqenies dhe dinjitetit njerëzor të realizuar me veprimtari të ligjshme dhe transparente.” Në rastin e programit Master Profesional “Komunikim Publik” ai është organizuar dhe mbështetur sipas kuadrit ligjor në fuqi, udhëzimeve të MASR, si edhe objektivave institucionalë të UAMD. Ky program ka objektiva të qartë që përputhen me rregulloren e tij dhe të Institucionit. Mbështetur në dokumentacionin e prezantuar, por edhe nga takimet në institucion, rezulton se ky program është çelur pas një analize të detajuar të tregut të punës, që synon nxitjen dhe zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. Ky studim ishte realizuar me të dhëna të mbledhura jo vetëm nga industria/ sektori që kërkon specialistë të kësaj fushe, por edhe me pyetësorë të realizuar me studentë të UAMD dhe maturan të shkollave të mesme. Si përfundim, mund të thuhet se Programi i studimit Master Profesional “Komunikim Publik” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Ky program mundëson pajisjen me njohuri dhe kompetenca profesionale në fushën e

	komunikimit publik, të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të institucioneve publike e private në vend.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2



Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e prezantuar, si Statuti i Ri, Plani Strategjik, Rregullorja e re, etj, rezulton se ky program studimi përputhet me strategjinë e zhvillimit të UAMD. Programi Master Profesional “Komunikim Publik” është hartuar në përputhje me këto rregullime dhe drejtimet strategjike të tij shprehen qartë në dokumentacionin e sipërpërmendur. Ndërkohë, Njësia kryesore ka hartuar një plan strategjik afatmesëm, i cili shërben edhe si udhëzues për rrugën që do të ndjek programi MP “Komunikim Publik”.</p> <p>Ndërkohë, plani strategjik për vitet 2016-2020 i UMAD parashikon zhvillimin e fakulteteve në funksion të përgatitjes shkencore dhe praktike të studentëve duke i përafruar ata me tregun e punës; Staf akademik cilësor, i përkushtuar, profesionist dhe etik; Kërkim shkencor në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, aftësimit të studentëve për t'u marrë me veprimtari kërkimore shkencore, brenda fushave të ekspertizës dhe investimit paraprak të çdo anëtarit të stafit akademik; Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie, në kërkimin shkencor dhe në shërbimet ndaj studentëve.</p> <p>Ky plan strategjik parashikon përmbushjen e misionit të Universitetit duke përdorur prioritetet strategjike, burimet njerëzore, financiare, infrastrukurore si dhe rrjetet e marrëdhënieve, duke krijuar, ruajtur dhe promovuar një sistem dinamik ndërlidhjes, me interes dhe frytshmëri shumëpalëshe, me përgjegjshmëri të lartë ndaj vlerave komunitare dhe sociale, për një të ardhme të qëndrueshme dhe nivel më të lartë të mirëqenies qytetare.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti dhe rregullorja e UAMD-së, rregulloret e fakultetit dhe departamentit, si dhe rregullorja e programit të studimit Master Profesional “Komunikim Publik”, përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të institucionit dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p> <p>Ky program studimi përputhet me parashikimet e bëra në Statutin e ri, Neni 8/2, Neni 80, Statuti i vjetër i UAMD në Nenin 4/1, në rregulloren e re të UAMD, Neni 10/2, dhe neni 41/3. Këto pikë reference përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të UAMD dhe demonstrojnë se dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>





<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Ky program studimi përputhet me kriteret e Kartës së Bolonjës dhe kuadrit ligjor për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij përputhet me fushat e drejtimet akademike të UAMD. Programi i studimit Master Profesional “Komunikim Publik” është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit, si program i ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional, i ngritur mbi programin e ciklit të parë të studimeve “Marrëdhënie me Publikun”. Ai ka objektiva të qarta për formimin e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Nisur nga një analizë paraprake e ofertës akademike të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri, Komunikimi Publik është një fushë e re studimesh dhe që përgjithësisht ka munguar në nivel programi studimi. Ai është ofruar përmes lëndëve/kurseve të posaçme, por në nivel programi akademik rezulton të jetë një risi. Programi Master Profesional “Komunikim Publik” i ofruar nga UAMD ofron një risi të kërkuar në tregun shqiptar. Programi ka synime të qarta për të zhvilluar tek studentët aftësi profesionale që mund t’i shërbejnë jo vetëm tregut vendas, por edhe më gjerë.</p> <p>Ai synon të aftësojë studentët në njohjen teknikave dhe praktikave më të fundit, si dhe në zotërimin e korpusit themelor të dijeve në fushën e komunikimit si një nga elementët më të rëndësishëm të aktualitetit dhe të së ardhmes e sidomos si një aspekt që mundëson tendencat globalizuese.</p> <p>Si përfundim, Programi Master Profesional “Komunikim Publik” mund të thuhet se është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



<p>Standardi I.3 Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi Master Profesional “Komunikim Publik” është hartuar me objektiva të qarta për formimin e studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që ata duhet të fitojnë në përfundim të studimeve. Mbështetur në rregulloren e këtij programi studimi, si edhe në planin mësimor të tij, rezulton se MP “Komunikim Publik” është hartuar me kujdes për të përgatitur studentë me formim të thelluar profesional, në fushën e komunikimit publik. Përmes një kurrikule të pasur dhe të përshtatur me realitetin dhe nevojat e tregut të punës në Shqipëri, studentët pajisen me njohuri të plota në fushën e marrëdhënieve me publikun, ku për ata që kërkojnë të vijojnë me kualifikimet më të avancuara shkencore, teknikat e ofruara e mundësojnë atë.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Duhet theksuar se UAMD dhe Departamenti i Shkencave Politike kanë treguar kujdes në analizën e situatës dhe zhvillimin e një studimi të zgjeruar të tregut të punës para hapjes së këtij programi studimi. Në këtë analizë janë përfshirë si aktorë të tregut që shërbejnë si punëdhënës, por edhe vetë studentët e UAMD në nivelin Bachelor, apo edhe maturanët të shkollave të mesme.</p> <p>Vlen për t'u vlerësuar puna e Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit, e cila nga vëzhgimet në institucion dhe nga dokumentacioni i prezantuar rezulton të ndjekë ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore.</p> <p>Kjo zyrë është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Disa prej trajnimeve të organizuara nga kjo zyrë kishin të bënin me mënyrën se si përgatitet një CV, përgatitja për një intervistë pune, etj.</p> <p>Ajo mban kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</p> <p>Sugjerim: <i>Nisur nga madhësia e UAMD, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, pavarësisht punës së lavdërueshme që bën, rezulton të jetë e pamjaftueshme për nevojat e të gjithë studentëve dhe programeve të studimit brenda këtij institucioni. Për një bashkërendim më efikas të punëve, sugjerohet që çdo njësi bazë të ketë një këshilltar karriere që të bashkëpunojë me këtë zyrë, gjë që do të lehtësonte procesin e integritit të studentëve në tregun e punës dhe lidhjen e tij me aktorë të ndryshëm të biznesit dhe institucioneve publike e private.</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>I përmendur edhe më sipër, ky program studimi përbën një risi në fushën e arsimit të lartë në Shqipëri. Ai është hartuar me objektiva të qarta dhe ka një kurrikul me lëndë të përzgjedhura shumë mirë dhe që ndihmojnë në përgatitjen profesionale të studentit. Lëndët praktike dhe Teza janë dy elementë që ndihmojnë akoma më shumë arritjen e synimeve që ka ky program. Programi dhe mënyra e organizimit të tij përgjithësisht u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> <p>Programi është i organizuar në dy semestra akademikë me sipas grupimit të mëposhtëm të lëndëve:</p> <p><i>Lëndë bazë të detyrueshme (A)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Statistikë sociale • Sociologji Komunikimi <p><i>Lëndë karakterizuese (B)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Marrëdhëniet me publikun dhe Zyra e Shtypit • Media, Politika dhe opinionimi publik • Diplomacia publike • Teoritë e aplikuara të komunikimit • Media dhe komunikimi publik • Komunikimi masiv bashkëkohor <p><i>Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Konceptim dhe menaxhim fushatash • Komunikimi i zhvillimit • Komunikimi politik ndërkombëtar




	<p><i>Lëndë plotësuese</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Praktika <p><i>Detyrime përmbyllëse (E)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Teza <p>Gërmat A – F janë përdorur si simbole për veprimtaritë e ndryshme formuese</p> <p>Sugjerim: <i>Duke qenë se programi është planifikuar të organizohet brenda një viti akademik, të ndarë në dy semestra, sugjerohet që të bëhet një balancim më i mirë i ndarjes së ngarkesës në planin mësimor. Mbështetur në planin mësimor të prezantuar, por edhe në intervistat e zhvilluara me GVB, Koordinatorin e programit dhe Dekanin e Fakultetit prej të cilit varet ky program, rezulton se në semestrin e parë studentët kanë një ngarkesë prej 18 kreditesh ECTC dhe 42 kredite ECTS të tjera ofrohen në semestrin e dytë. Situata justifikohet se lënda e Praktikës dhe Teza, edhe pse nisin që në fillim të semestrit të dytë, janë lëndë që mund të merren vetëm pasi studenti të ketë përfunduar me sukses të gjitha provimet e lëndëve të tjera. Kjo formë implementimi, çon në zgjatjen e detyrueshme të studimeve edhe për gjatë muajve të verës.</i></p> <p><i>Si përfundim, sugjerohet që të bëhet një balancim më i mirë i planit mësimor, përfshirë këtu edhe heqjen e parakushteve për marrjen e tezës dhe të lëndës së praktikës.</i></p> <p>Referuar Nenit 19 të rregullores së këtij programi, studenti që ka fituar të gjitha pikët kredite të të gjitha lëndëve, pra ka rezultuar kalues në të gjitha lëndët e ofruara nga Programi Master Profesional “Komunikim Publik” fiton të drejtën për fillimin e praktikës mësimore në periudhën e caktuar nga Fakulteti i Shkencave Politike Juridike. Kohëzgjatja e praktikës është jo më pak se 2 muaj.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga shpjegimet e GVB, rezulton se në hartimin e këtij programi janë referuar disa universitete ndërkombëtare, kryesisht amerikane, të cilët e kanë patur pjesë të historisë së tyre komunikimin publik. Ndërkohë, kurrikula e këtij programi, me të gjithë komponentët e saj lehtëson lehtëson transferimit të studimeve, apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. Edhe pse deri më tani nuk ka pasur raste mobiliteti, duke qenë se ky është ende një program i ri brenda UAMD, studentët mund të kryejnë mobilitet në kuadrin e projekteve dhe programeve ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MP “Komunikim Publik” është hartuar dhe zbatohet konform rregullave dhe parimeve të Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Diplomat ofrohen në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe vlerësimi shprehet sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemit Amerikan të Krediteve, për të krijuar lehtësi lexueshmërie, transferimin dhe vazhdimin e studimeve universitare pranë institucioneve arsimore të Arsimit të Lartë brenda vendit, rajonit e më gjerë. Programi i studimit Master Profesional “Komunikim Publik” përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat vlerësohen kundrejt krediteve ECTS. Me qëllim lehtësimin e integritit të studentëve të diplomuar në këtë program studimi, në kuadër të politikave të UAMD-së në tregun kombëtar e ndërkombëtar akademik dhe të punës, ofrohet edhe konvertimi në kredite UsCr.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, por edhe kontakteve që GVJ zhvilloi me përfaqësues të Zyrës së karrierës dhe</p>

<p>aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Koordinatorin e programit, rezulton se programi i studimit Master Profesional “Komunikim Publik” bazohet në përfshirjen e tyre në kryerjen e praktikave profesionale, të cilat realizohen pranë institucioneve publike, apo bizneseve private në nivel kombëtar, si dhe lokal. Këto praktika profesionale realizohen dhe janë në përputhje me objektivat e programit të studimit. Teksa angazhimi i institucionit për zhvillimin e lidhjeve me aktorët e tregut mbetet një veprim për t’u lavdëruar, <i>sugjerohet një organizim më i mirë i planifikimit të praktikës, duke e përfshirë atë brenda semestrit të dytë, dhe jo duke e zgjatur atë përgjatë muajve të verës, gjë kjo që vështirëson shkallën e ndjekjes së këtij programi për ata studentë që studimet e tyre të këtij cikli dëshirojnë t’i përmbyllin brenda një viti akademik, në rastin konkret, brenda dy semestrave akademik.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Komunikim Publik” ofrohet në gjuhën shqipe. Nga diskutimi i zhvilluar me GVB, por edhe me studentët e këtij programi, rezulton se në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shkëmbimit e eksperiencave janë zhvilluar disa leksione të hapura nga profesorë, studiues e personalitete vendas ose të huaj, të cilat kanë shërbyer si burim njohurish të shtuara për studentët, por edhe si ura lidhëse me institucione të ngjashme arsimore dhe aktorë të tregut të punës. sipas profileve përkatëse në përputhje me objektivat e programit të studimit. Nga ana tjetër. Stafi i kontaktuar gjatë vizitës në institucion rezulton të jetë me një eksperiencë të kënaqshme jo vetëm brenda vendit, por edhe në dsa shtete të bashkimit Evropian, ku ka universitete me të cilët UAMD ka vendosur ura bashkëpunimi.</p>			
<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



<p>Standardi I.4 Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Analizuar nga aspekti i infrastrukturës, gjatë vizitës në institucion u vu re se mjediset në funksion të këtij programi studimi ishin shumë të kënaqshme, duke përmbushur të gjitha nevojat e tij. Nga aspekti i kapaciteteve dhe burimeve të nevojshme në fushën akademike, Institucioni i përmbush këto kritere, pasi vetë programi është në vijimësi të një tradite të mirë të fituar gjatë implementimit të programit që ofron në Ciklin e parë, Bachelor në Marrëdhënie</p>

	Publike. Ndërkohë, disa nevoja specifike rezultojn se janë përmbushur me angazhimin e stafit me kohë të pjesshme.			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Komunikim Publik” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, fakultetit, dhe njësisë bazë, Departamentit të Shkencave Politike, përgjegjës për këtë program, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit dhe sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. E përmendur edhe në kriterin e mësipërm, MP “Komunikim Publik” pason një program të ciklit të parë, Bachelor në Marrëdhënie Publike.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MP “Komunikim Publik” përputhet me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, konkretisht të Departamentit të Shkencave Politike, i cili është përgjegjës për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Fakulteti i Shkencave Politike Juridike dhe Departamenti i Shkencave Politike pranë UAMD nuk ofrojnë programe studimi “Master profesional” jashtë profilit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe	Nga informacioni i mbledhur gjatë vizitës në institucion, por edhe nga evidencat që shoqërojnë raportin e vlerësimit të brendshëm rezultojn se Departamenti i Shkencave Politike, në funksion të mbarëvajtjes së punës në drejtim të zbatimit të programit mësimor në Master profesional “Komunikim Publik” bashkëpunon me edhe me departamentet e tjera brenda Fakultetit ku bën pjesë, kryesisht kur bëhet fjalë për ndarjen e ngarkesës mësimore, por edhe të aktiviteteve






<p>analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>të ndryshme jashtë kurrikulare, si leksione të hapura, organizime shkencore etj. Ky bashkërendim vihet re edhe në zyrat e ndryshme të institucionit, të cilat angazhohen me detyrat administrative si burimet njerëzore, sekretëria mësimore, biblioteka, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike, si njësi kryesore e UAMD, për realizimin e objektivave të programit të studimit, si dhe procesit mësimor e formues të studentëve, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. Përgjithësisht këto marrëveshje janë realizuar në nivel institucional, prej të cilave përfiton edhe Departamenti i Shkencave Politike me të gjithë programet e studimit që ai ofron. Në lidhje me aktorët e biznesit, Zyra e Karrierës mban një lidhje të ngushtë me shumë prej tyre, si edhe ndan me studentët të gjitha mundësitë për praktika dhe për vende pune.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë "Master profesional", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>UAMD ka nënshkruar shumë marrëveshje ndër-institucionale, qofshin këto me institucione arsimore, apo edhe aktorë të tregut publik ose privatë, të cilat edhe pse në nivel institucional, shërbejnë për mbarëvajtjen e mirë të programit MP "Komunikim Publik". Në këtë drejtim, vlen të përmendet edhe komunikimi që Zyra e Karrierës zhvillon me studentët në përgjithësi, si përmes faqes së Institucionit, po ashtu edhe me afishimet që bëheshin në mjediset e Universitetit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike Juridike dhe Departamenti i Shkencave Politike kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi, në funksion të realizimit të programit të studimit lidhur me kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale, me bashki e njësi administrative, si dhe me aktorë të bizneseve private të fushës, me qëllim mundësimin e realizimit të aftësimit praktik të studentëve drejtpërdrejtë në kontakt me funksionin e komunikimit publik.</p> <p>Nga takimi i zhvilluar me studentë, por edhe me Koordinatorin e programit dhe anëtarë të tjerë të stafit akademik, u mësua se edhe pse Institucioni i orienton studentët drejt disa institucioneve me të cilat bashkëpunon për realizimin e praktikave, një pjesë e konsiderueshme e tyre ishin të angazhuar në mënyrë individuale për të gjetur mundësitë e praktikës.</p> <p>Kjo gjë parashikohet edhe në Rregulloren e programit të studimit, e cila në nenin 19 të saj vlerëson se vendi i praktikës do të përcaktohet nga vetë studentët. Institucioni ku zhvillohet praktika duhet të jetë i miratuar nga IAL kundrejt marrëveshjeve të bashkëpunimit. Në përfundim paraqitet vërtetimi dhe raporti i praktikës nga institucioni ku është zhvilluar ajo, me firmën dhe vulën e titullarit. Në përfundim të praktikës, studenti duhet të bëjë mbrojtjen e saj përpara një Komisioni. Për mbrojtjen e praktikës studenti prezanton dhe mbron raportin e saj përpara komisionit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e</p>	<p>Institucioni nuk ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>



diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.				
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Mbështetur në analizën vjetore të Departamentit të Shkencave Politike, rezulton se ai ka kryer një analizë vjetore të punës, ku ka argumentuar edhe përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit në fjalë, por edhe të gjithë programeve që ofron.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim Publik” është i organizuar në lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe detyrime përmbyllëse, duke respektuar legjislacionin vendës në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS).
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Parashikuar edhe në rregulloren e programit MP “Komunikim Publik” synon të formojë studentë duke u bazuar në njohuri që ndërthurin disiplina duke punuar për përgatitjen e studentëve me njohuri të menaxhimit të organizatës sa i takon marrëdhënieve publike në tërësi dhe komunikimit publik në veçanti. Në Nenin 6 të Rregullores së programit theksohet se misioni i Masterit Profesional në “Komunikim Publik” është <ul style="list-style-type: none"> a) Të përgatisë ekspertë komunikimi të aftë për t’u angazhuar në menaxhimin e marrëdhënieve publike në sektorët ndryshëm; b) Të përgatisë specialistë e analistë të aftë në fushën e komunikimit; c) Përgatitja e kualifikimit shkencor për studime doktorate të mëtejshme, etj.
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Neni 7 i rregullores së këtij programi parashikon se veprimtaria e tij parashikon studime të thelluara të teorive dhe modeleve bashkëkohore të komunikimit; studime të thelluara mbi procesin e komunikimit dhe të gjitha hallkat nëpër të cilat kalon mesazhi; Njohuri mbi shumicën e formave të njohura të kodifikimeve të komunikimit. Kjo vërtetohet edhe përmes Syllabuseve të lëndëve që ofrohen përmes këtij programi, ku studentët marrin njohuri, të cilat zhvillojnë koncepte kyçe, bazuar në teoritë e ndryshme të komunikimit duke zhvilluar mendimin dhe të kuptuarit kritik rreth thellimit dhe aplikimit të tyre në organizata e institucione.
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Referuar syllabuseve të lëndëve të Masterit Profesional në Komunikim Publik, në këtë program studimi zhvillohen kompetenca kyçe të avancuara duke i gërrshetur me një qasje pragmatike për zgjidhjen e situatave në organizata e institucione. Kjo gjë u theksua edhe nga anëtarët e stafit akademik pjesëmarrës në takimin që u zhvillua në institucion, por u shpreh si një pikë e lavdërueshme edhe nga studentët e këtij programi.
Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të	Programi “Master Profesional “Komunikim Publik” ka hartuar Rregulloren për këtë program specifik studimi. Në rregullore, janë zbatuar


gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	<p>kërkesat e Vendimit nr.41, datë 24.01.2018 për elementët e nevojshëm të përcaktuar të studimit të ofruar. Këto element janë të përcaktuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kreditet janë të ndërtuara sipas sistemit ECTS; ▪ Kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlerësimit janë të ndërthurur nëpërmjet testimeve me shkrim, detyrave praktike dhe prezantimeve në grup dhe individuale dhe tezave të diplomës; ▪ Objektivat formuese dhe profesionale janë të saktësuar sipas detyrimeve ligjore; ▪ Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit janë të ndara në orë auditori, punë individuale, veprimtari praktike, provim diplome; ▪ Plani mësimor dhe programi lëndor (<i>syllabus-et</i>) janë të përcaktuar qartë; ▪ Rregullorja përcakton qartë proceduarat e pranimit; ▪ Rregullorja përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet e studentëve. 			
<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi Master Profesional “Komunikim Publik” ka këto kategori lëndësh:</p> <p>A – Lëndë Bazë – 6 ECTS - 10%</p> <p>B – Lëndë Karakterizuese – 24 ECTS - 40%</p> <p>C – Lëndë Ndërdisciplinore -12 ECTS - 20%</p> <p>D – Lëndë Plotësuese -6 ECTS - 10%</p> <p>E – Detyrime Përmblyëse -12 ECTS 20%</p> <p>Kjo ndarje respekton Vendimin nr. 41 për ndarjen e krediteve në Master Profesional</p>			
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore, Masteri Profesional në “Komunikim Publik” lëndët i ka të grupuara në lëndë të detyrueshme, karakterizuese dhe ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmblyëse me ngarkesën përkatëse në kredite. Ky program parashikon kredite për praktikën mësimore apo laboratorë si lëndë e veçantë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.2



Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, si njësi kryesore, dhe Departamenti i Shkencave Politike, si njësi bazë, disponojnë një</p>

<p>ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>strukturim organizativ në çdo shkallë të hierarkisë duke iu përshtatur nevojave të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike (FSHPJ) është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 685, datë 25/08/2010 si një nga njësitë kryesore të Universitetit “Aleksandër Moisiu” (UAMD).</p> <p>Fakulteti përbëhet nga këto departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Drejtësisë • Departamenti i Shkencave Politike • Departamenti i Administrimit Publik
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Programet që ofron Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 6 (gjashtë) programe studimi me kohë të plotë në Ciklin e Parë të Studimeve: Drejtësi, Shkenca Politike, Marrëdhënie me Publikun, Histori, Administrim Publik, dhe Politikë Ekonomike. • 5 (pesë) programe studimi në Në Ciklin e Dytë, Master i Shkencave: E Drejtë Private, E Drejtë Ndërkombëtare Publike, Gjeopolitika dhe Sistemet e Sigurisë, Administrim Publik, Administrim Financiar. • 6 (gjashtë) programe studimi në Ciklin e Dytë, Master Profesional: E Drejtë Prone, E Drejtë Tregtare Ndërkombëtare, E Drejtë Detare, Administrim Publik, Administrim Financiar, Drejtim Turizmi. • 1 (një) program studimi në Ciklin e Tretë, Doktoraturë në Administrim Publik.
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Ndërkohë, Stafi Akademik i Departamentit të Shkencave Politike është i përbërë nga 17 anëtarë, ku 2 anëtarë janë me titullin Prof.Dr, 6 janë Prof.Asoc.Dr, dhe 8 anëtarë janë me Gradën Shkencore “Doktor Shkencash”</p> <p>Nisur nga sa më sipër, rezultojnë se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit MP “Komunikim Publik” përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Në lidhje me këtë program studimi, plani mësimor përgjithësisht mbështetet dhe realizohet nga stafi akademik i emëruar varësisht procedurave të përcaktuara brenda institucionit. Stafi akademik rezultojnë të jetë kompetent për lëndët që mbulon. Nisur nga takimet e zhvilluara në institucion rezultojnë se në këtë program studimi nuk ka pasur nevojë për staf akademik ndihmës.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Rregullorja e Programit MP “Komunikim Publik” parashikon caktimin e një koordinatori të programit, duke specifikuar edhe detyrat e tij. Neni 11 i kësaj rregulloreje specifikon se Koordinatori është drejtuesi i Masterit. Ai përgjigjet për përmbushjen e Masterit Profesional “Komunikim Publik” dhe ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për veprimtarinë e gjithanshme të tij. Konkretisht, disa nga detyrat e koordinatoriit janë:</p>






<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>a) Të drejtojnë punën për hartimin, ndryshimin e rregullores së Masterit Profesional “Komunikim Publik”; për përgatitjen e strategjisë së zhvillimit; për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik; planin mësimor etj.</p> <p>b) T’i propozojë Grupit Kërkimor Shkencor miratimin e programeve mësimore;</p> <p>c) Të hartojë orarin e mësimëve, të provimeve dhe të ndjek zbatimin e tyre;</p> <p>d) Të ndjek ecurinë e veprimtarisë mkërkimore dhe të procesit të tezës;</p> <p>e) T’i propozojë Asamblesë se Departamentit kriteret e pranimit të studentëve;</p> <p>f) T’i propozojë Dekanit komisionet e pranimit të studentëve, komisionin e miktotezës së diplomës dhe komisionet e diplomimit;</p> <p>g) Të organizojë vlerësimin e brendshëm të Masterit Profesional “Komunikim Publik”,</p> <p>h) Etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				
<p>Standardi II.3</p>				
<p>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</p>				
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>			
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Politike pranë Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike disponon informacionin e duhur për strukturimin e programit MP në “Publik”. Programi i studimit është i ndërtuar me lëndë të kategorive A, B, C, D, E dhe i ndarë në orë mësimore. Studentët në program fitojnë 60 ECTS të ndara në dy semestra përgjatë një viti akademik, me 32 javë mësimore në auditorë.</p>			
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Lëndët kanë numër kreditesh ECTS të caktuar paraprakisht, të ndara ato në mënyrë të saktë varësisht veprimtarive formuese. <i>E thënë edhe më sipër, sugjerohet balancim më i saktë i ngarkesës së dy semestrave, përsa i përket numrit të ETCS.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>				
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit,</p>	<p>Programi MP “Komunikim Publik” ka të dokumentuar të gjitha syllabuset e lëndëve. Në to janë dhënë në mënyrë të detajuar detaje si Titullari i lëndës, Ngarkesa mësimore në kreditë dhe orë mësimore,</p>			



frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Tipologjia e lëndës sipas klasifikimeve dhe llojin në kurs të detyrueshëm apo me zgjedhje. Në program jepen konceptet kryesore dhe tematikat që do të trajtohen. Aty gjën edhe format e frekuentimit dhe kontrollit të dijeve dhe mënyrat e vlerësimit dhe pikëzimit të studnetit. Syllabuset kanë edhe adresën elektronike e titullarit të lëndës.			
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Sekretaria mësimore i ofron studentëve informacionin e nevojshëm për procedurat dhe rregullat që duhet të ndjekin në rast të transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit të krediteve që ata kanë marrë në një program studimi. Gjithashtu sekretaritë nësimore japin informacion edhe për orarin, sezonet dhe datat e provimeve etj. Politikat e pranimit janë të shpallura që në përfundim të vitit të mëparshëm mësimor për kriteret e përgjithshme dhe specifike të rregjistrimit në programet e studimet.			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Syllabuset janë të plota, më të gjithë elementët: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit; ▪ Konceptet themelore; ▪ Orët në auditor dhe si punë individuale; ▪ Temat e programit mësimor të lëndës specifike; ▪ Formën e kontrollit të dijeve; ▪ Literaturën; etj Të gjithë këto elementë përputhen me formatet e miratuara në fuqi.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Ky program ka nxjerrë vetëm një brez të diplomuarish dhe konsiderohet ende i ri në tregun e arsimit të lartë në Shqipëri. Programi është ndërtuar dhe bazuar në eksperiencat e universiteteve të huaja. Por, për t'u lavdëruar mbetet praktika që Njësia bazë ndjek për rishikimin dhe përditësimin e sylabuseve në çdo fillim viti akademik, të propozuara këto nga titullari i lëndës dhe të miratuara nga Përgjegjësi i njësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit Master Profesional “Komunikim Publik” është i ndërtuar në një vit akademik, me dy semestra dhe 60 kredite të shpërndara njëtrajtësisht në mënyrë të barabartë midis lëndëve. Ngarkesa e programit është e strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

	<i>E përmendur edhe më sipër, sugjerohet ndarje më e mirë e ngarkesës së lëndëve sipas krediteve ECTS midis dy semestrave. Gjithashtu, lënda e praktikës dhe teza sugjerohet të jenë pa kushte paraprake dhe të nisin që në fillim të semestrit të dytë.</i>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi Master Profesional “Komunikim Publik” ka një shpërndarje të lëndëve midis dy semestrave, ku në semestrin e parë jepen njohuritë kryesore teorike dhe në semestrin e dytë kushtohet më shumë kohe studimi lëndëve që kanë të bëjmë me aspektin profesional. Edhe pse natyra e lëndëve përputhet me formimin profesional të studentëve, <i>sjellim në vëmendje</i> shqetësimin e mësipërm për një balancim më të mirë të ngarkesës mësimore, me një mesatare prej 30 ECTS në semestër. Plani mësimor aktual e ndan këtë ngarkesë në 18 ECTS në semestrin e parë dhe 42 në semestrin e dytë. Sipas shpjegimeve të bëra nga GVB, Dekani i Fakultetit dhe Koordinatorin e programit, nga aspekti teorik semestri i dytë ka një ngarkesë prej 24 ECTS. Ndërkohë, praktika dhe teza, të cilat gjithsej kanë 18 ECTS parashikohen të zhvillohen pas përfundimit me sukses të të gjitha provimeve të lëndëve të tjera.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Nga ana tjetër, raporti teori-praktikë përputhet me profilin e programit në fjalë, por edhe me shembuj të tjerë në universitetet jashtë vendit.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Duhet theksuar fakti se përzgjedhja e lëndëve dhe grupimi i tyre sipas veprimtarive të ndryshme formuese e bën programin MP “Komunikim Publik” një program studimi të qëndrueshëm dhe të hartuar në mënyrë shumë profesionale. Ka një ndarje të logjikshme të lëndëve që jepen në semestrin e parë dhe atyre me të cilat vijohet në semestrin e dytë. Ndërkohë, lëndët anë grupuar sipas veprimtarive të ndryshme formuese duke respektuar edhe kuadrin ligjor në fuqi përse i përket ngarkesës që ato kanë në të gjithë planin mësimor. Përse më sipër, ndarja është e organizuar në këtë mënyrë: A – Lëndë Bazë – 6 ECTS - 10% <ul style="list-style-type: none"> • Statistikë sociale • Sociologji Komunikimi B – Lëndë Karakterizuese – 24 ECTS - 40% <ul style="list-style-type: none"> • Marrëdhëniet me publikun dhe Zyra e Shtypit • Media, Politika dhe opinionin publik • Diplomacia publike • Teoritë e aplikuarat të komunikimit • Media dhe komunikimi publik • Komunikimi masiv bashkëkohor C – Lëndë Ndërdisciplinore -12 ECTS - 20% <ul style="list-style-type: none"> • Konceptim dhe menaxhim fushatash • Komunikimi i zhvillimit • Komunikimi politik ndërkombëtar



	<p>D – Lëndë Plotësuese -6 ECTS - 10%</p> <ul style="list-style-type: none"> • Praktika <p>E – Detyrime Përmblyëse -12 ECTS 20%</p> <ul style="list-style-type: none"> • Teza <p>Kjo ndarje respekton Vendimin nr. 41 për ndarjen e krediteve në Master Profesional</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik të departamentit dhe GVB, por edhe referuar raportit të vlerësimit të brendshëm rezultojnë se sylabuset e të gjitha programeve brenda UAMD rishikohen në çdo fillim viti akademik nga lektorët përkatës dhe miratohen nga Drejtuesi i Njesisë Bazë. Për programin MP “Komunikim Publik” është praktikuar e njëjta mënyrë, por duke qenë se ai është ende shumë i ri dhe sylabuset janë përgatitur gjatë dy viteve të fundit, ndryshimet janë shumë të vogla. Por, për t’u vlerësuar pozitivisht mbetet praktika e përditësimit të vazhduar dhe e miratimit nga drejtuesi i njesisë bazë të sylabuseve në çdo fillim viti akademik.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Pas shqyrtimit që iu bë programit të studimit dhe sylabuseve të lëndëve në MP “Komunikim Publik” vihet re një ndërthurje e kënaqshme e lëndëve të nevojshme për formimin profesional të studentëve. Vijimësia midis natyrës së lëndëve të semestrit të parë me ato të semestrit të dytë i ndihmon studentët që të integrojnë mirë konceptet teorike me ato praktike.</p>			
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>				
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ në universitetet dhe në takimet me studentët që kanë përfunduar të parët Masterin Profesional “Komunikim Publik” vërehet se edhe pse numri i tyre është ende i ulët, pasi ka vetëm një vit të diplomuarish, pjesa më e madhe e tyre është e punësuar në fusha të ngjashme me studimet e tyre. Studentët pohuan se formimi akademik dhe profesional i ofruar përmes këtij programi studimi i ka ndihmuar ata për të gjetur hapësira punësimi në fushën ku ata kanë studiuar. Edhe pse bëhet fjalë për një grup të vogël të diplomuarish, ky është një tregues se programi MP “Komunikim Publik” është në përshtatje me pritshmëritë e tregut të punës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme në programin mësimor MP “Komunikim Publik” janë të gjithë me gradën shkencore Doktor i Shkencave. Kjo është në përputhje me standartet ligjore të përcaktuara nga Ministria e Arsimit.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Duke qenë se programi Master Profesional “Komunikim Publik” vjen në vijimësi të një programi të ngjashëm të ciklit të parë, BA në Marrëdhënie Publike, Departamenti i Shkencave Politike duket se ka ndërtuar një traditë të mirë në organizimin e programeve të kësaj natyre, qoftë kjo nga cilësia e kurrikulës, por edhe nga stafi akademik cilësor i angazhuar në këtë program. Si personeli akademik me kohë të plotë, po ashtu edhe ai me kohë të pjesshme kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. Titullarët e lëndëve janë përcaktuar kryesisht varësisht fushës së ekspertizës, gjë kjo që ndihmon në mbarëvajtjen e të gjithë procesit. Përgjegjësi i programit të studimit është me gradën Dr. dhe ka një përvojë të konsiderueshme akademike. Stafi akademik i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit kanë grada shkencore dhe tituj akademik (1 me titull Profesor Doktor, 3 me titull Profesor të Asociuar, 7 me gradë shkencore Doktor). 82% e ngarkesës së programit është realizuar me pedagogë të brendshëm. Sa i takon personelit të jashtëm, të gjithë janë me grada e tituj shkencorë. Varësisht numrit të ulët të studentëve të këtij programi, raporti pedagogë/studentë është mjaft i ulët, çka mundëson një përkushtim të madh të personelit akademik ndaj studentëve të programit, dhe mbikëqyrje të mirë të praktikave profesionale. Kjo gjë u pranua edhe nga studentët me të cilët GVJ u takua gjatë vizitës në Institucion.
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike	E përmendur edhe mësipër, UAMD ka nënshkruar një sasi të konsiderueshme marrëveshjesh me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, por edhe me aktorë të ndryshëm të biznesit. Këta të fundit ndihmojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për realizimin e praktikave si edhe ndjekjen e studentëve gjatë gjithë periudhës që ndodhen në këto institucione. Një përfaqësuese biznesi ishte angazhuar gjithashtu edhe në pozicionin e ekspertes së jashtme në hartimin e raportit të vlerësimit në brendshëm nga GVB.



sipas natyrës së programit të studimit.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në lidhje me infrastrukturën laboratorike, programi MP “Komunikim Publik” është vlerësuar të mos e ketë atë si një domosdoshmëri për zhvillimin e tij. Infrastruktura që ofron godina e Njesisë kryesore ka një laborator kompjuterësh të pajisur me njësi cilësore dhe që në rast nevojë mund të përdoren nga studentët dhe stafi për mbarëvajtjen e programit. Nga verifikimet në mjediset e universitetit vihet re se UAMD dhe Fakulteti i Shkencave Politike angazhon personel ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Duke qenë se MP në “Komunikim Publik” është ende i ri, vetëm në vitin e dytë të aktivitetit të tij, ky kriter mbetet i plotësuar varësisht angazhimit dhe konsultimit që institucioni ka pasur me aktorët e tregut para hapjes së programit. UAMD ka zhvilluar një studim të detajuar tregu, ku ka përfshirë jo vetëm studentë dhe maturan të shkollave të mesme, por edhe shumë aktorë të biznesit dhe institucioneve të ndryshme publike dhe private.
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Opinionin e studentëve merret përmes dy formave. E para me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve në organet kolegjiale të UAMD dhe e dyta përmes rezultateve të mbledhura nga anketat që zhvillohen me ta në çdo fund të semestrit. Të dhënat e dalta nga këto anketa, përpunohen dhe analizohen në nivelet drejtuese, ku në rast se ka një pakënaqësi të konsiderueshme të studentëve në lidhje me një lëndë të caktuar apo pedagog, Njësia merr masat e nevojshme për të ndërhyrë në përmirësimin e situatës.
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Zyra e Karrierës dhe Praktikave është ajo që mban lidhje të drejtpërdrejta me studentët e diplomuar. UAMD ka një strukturë të posaçme ALUMNI, e cila gjatë vitit, e cila organizon disa evente me pjesëmarrjen e të diplomuarve. Praktikë motivuese është ceremonia për dhënien e disa çmimeve që UAMD jep për të diplomuarit e tij më të suksesshëm. Ndërkohë, duke qenë se ky program studimi i ka nxjerrë të diplomuarit parë vetëm para një viti, Zyra në fjalë kishte të gjitha kontaktet me ta.


	<p>Zyra e Alumnive në mënyrë periodike përditëson databazën e të dhënave rreth të diplomuarve.</p> <p>Institucioni përmes strukturave të tij, ALUMNI, mban lidhje me studentët e diplomuar, të cilët kontaktohen vazhdimisht përmes formave të ndryshme të komunikimit, duke marrë prej tyre propozime të mundëshme në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>Mbështetur në evidencat e paraqitura dhe në takimet e zhvilluara në institucion, rezulton se UAMD, FSHPJ dhe DSHP në kuadër të përmirësimit dhe riorganizimit të programeve të posaçme të studimit, kontakton me grupet e interesit, qofshin publike apo private, duke marrë në konsideratë nevojat specifike lokale, apo dhe më gjerë, të cilat u vijnë në ndihmë të studentëve për të qënë më afër kërkesave të tregut.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Mbështetur në evidencat e paraqitura Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, ofron kushtet e nevojshme infrastrukture për aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies. Nga vizita në institucion e ekspertëve të jashtëm për akreditimin e këtij programi studimi, u evidentua se auditorët janë të paisur me të gjitha kushtet e nevojshme për të mundur aplikimin e metodave inovative. Nga ana tjetër institucioni nxit stafin akademik për organizimin e formave interkative të mësimdhënies nëpërmjet lektorëve të ftuar në lëndë të ndryshme dhe organizimit të leksioneve të hapura. Gjatë takimeve me stafin akademik të programit Master Profesional në Komunikim Publik, u evidentua angazhimi i pedagogëve për zhvillimin e leksioneve duke ndërthurur metoda si prezantime në poëerpoint, imazhe, video, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Politike, në të cilën ofrohet programi Master Profesional në Komunikim Publik, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike dhe Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës kanë një kuadër të plotë të mekanizmave të monitorimit të cilësisë së stafit. Monitorimi dhe vlerësimi bëhet në mënyrë periodike dhe ofron të dhëna të rëndësishme për të kuptuar nivelin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në bashkëpunim me njësitë bazë dhe njësitë kryesore, organizon anketimet periodike me studentët. Nga biseda me grupin e vlerësimit të brendshëm të programit dhe NJSBC-në doli në pah fakti se institucioni ka një marrëveshje me një kompani për analizimin kompjuterik të anketave dhe hartimin e raporteve. Në nenin 2 dhe 10 të Rregullores së NJSBC, si dhe në nenin 80 i Statutit të Ri të institucionit janë të parashikuara strukturat dhe mekanizmat përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e personelit akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni përfshin studentët në procesin e vlerësimit periodik për metodat dhe format me mësimdhënies. Studentët bëhen pjesë e procesit, duke vlerësuar aftësitë dhe njohuritë e stafit akademik ç’do fund semestri. Përfshirja e studentëve është e përcaktuar në nenin 6 të Rregullores së NJSBC. Ndërkohë Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Politike -Juridike ka krijuar mundësi për trajtimin e ankesave të studentëve. Përfshirja e studentëve në këtë proces u evidentua edhe gjatë takimit të GVJ me studentët e programit master profesional në komunikim publik. Studentët treguan eksperiencën e tyre në plotësimin e pyetësorëve dhe masat e marra nga departamenti për të ruajtur konfidencialitetin e pjesëmarrësve në anketim.</p>




<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitoimin dhe sigurimin e cilësisë, bën administrimin e rezultateve dhe më pas i shpërndan ato te strukturat vendimmarrëse si: fakulteti, departamenti, personeli akademik dhe atij administrativ. Titullarët e këtyre strukturave marrin në shqyrtim rastet bazuar në rezultatet e anketimeve. Publikimi i rezultateve është bazuar në Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Në nenin 8 dhe 9 të kësaj rregullorje ka një shpjegim për mënyrën se si organet drejtuese të universitetit dhe personeli akademik merr dijeni për aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet e brendshme, si statuti, rregullore e brendshme, etj. Në faqen zyrtare të IAL-së, publikohen vendimet e senatit, Bordit të Administrimit dhe rektoriatit. <i>Sugjerohet që në faqen e internetit të krijohet një hapësirë e posaçme për publikimin e raporteve të cilësisë dhe analizat e anketimeve të studentëve.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni ka një qasje pozitive për të promovuar shembujt dhe praktikat e mira në mësimdhënie. Në mënyrë të veçantë lektorët me arritje në këtë pikë, marrin përparësi gjatë vlerësimit të aplikimeve për programet e mobilitetit të stafit akademik. Njësitë përgjegjëse në UAMD, siç është NJSBC dhe më pas, njësitë bazë dhe ato kryesore pas marrjes së rezultateve të anketimeve dhe vlerësimeve periodike, stimulojnë dhe inkurajojnë personelin akademik në drejtim të rritjes së performancës në mësimdhënie. Neni 6 i rregullores së NJSBC-së parashikon mënyrën bërjes së vlerësimit për procesin mësimor. Është e nevojshme që institucioni të parashikojë stimuj konkretë për lektorët që arrijnë rezultate të larta vlerësimi për cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e metodave inovative.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura nga grupi i vlerësimit të brendshëm (GVB) dhe verifikimet e bëra gjatë vizitës së ekspertëve në institucion, është parë se Programi Master Profesional në Komunikim Publik aplikon si forma të mësimdhënies dhe mësimnxënies, seminarët, leksionet, orët mësimi të leksioneve të integruara me seminarët, ushtrimet, projektet/detyrat kursit individuale dhe/ose në grup, provimet e ndërmjetme dhe provimet përfundimtare. Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore si dhe në nenin 60 të Rregullores së UAMD-s dhe Statuti i Ri të UAMD.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi</p>	<p>Kombinimi i formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke patur parasysh diversitetin e nevojave të studentëve, reflektohet në përditësimin e syllabuseve të lëndëve për çdo vit akademik duke përditësuar dhe format e reja të mësimdhënies dhe kombinimin e tyre varësisht nevojave të studentëve. Nga ana tjetër personeli akademik i</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

24

<p>alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Departamentit të Shkencave Politike angazhohet për përmirësimin e dijeve dhe aftësive për tju përgjigjur nevojave të studentëve. Përshtatja dhe përditësimi i syllabuseve kalon nëpërmjet procesit të vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie. Mekanizmi i anketimit dhe analizimi i të dhënave të dala janë një rrugë e mirë për të reflektuar nevojat e studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Departamenti ka ndjekur një politikë aktive në bashkëpunimin me punëdhënësit potencialë për studentët e diplomuar nga ky program master. Kjo ka çuar në reflektimin e nevojave të tregut në procesin mësimdhënës duke u përshtur si në metodat e mësimdhënies ashtu edhe në përfshirjen e inovacionit. Nga vlerësimi i komunikimit me personelin akademik gjatë vizitës së ekspertëve të jashtë në institucion, u konstatua se departamenti inkurajon stafin të përmirësojë aftësitë dhe kompetencat didaktike, në mënyrë që programi i studimit të jetë në përputhje me rezultatet e pritshme dhe objektivat formuese.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga analiza i Cv-ve të stafit dhe bashkëbisedimi i bërë me personelin akademik, gjatë vizitës së ekspertëve të jashtëm në institucion, vihet re se anëtarët e personelit akademik kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të plotësuar objektivat e programit. Në personelin akademik ka lektorë me formim në fushëm e komunikimit dhe medias në universitete brenda dhe jashtë vendit. Personeli akademik përdor metoda të ndryshme mësimore, duke u përshtatur tipologjive të lëndëve dhe mundësisë për një mësimnxënie efikase.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni ka përfshirë në procesin e vlerësimit të metodave të mësimdhënies studentët nëpërmjet anketimit dhe vlerësimit periodik. Ky vlerësim bëhet në çdo fund semestri. Studentët plotësojnë pyetësorët ku pyeten për performancën e lektorëve si dhe metodat apo format që secili lektor aplikon gjatë lëndës së tij. Gjatë bashkëbisedimit me grupin e studentëve të programit, u konstatua se ky proces është gjithëpërfshirës. Studentët gjatë bashkëbisedimit me grupin e ekspertëve të jashtëm vlerësuan ruajtjen e anonimatit gjatë realizimit të anketimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Nga vlerësimi i evidencave të paraqitura vihet re se departamenti i shkencave politike është përpjekur të përfshijë interaktivitetin në mësimdhënie përmes individëve të ftuar si përfaqësues të biznesit dhe institucioneve publike. Leksionet e hapura me figura të ndryshme publike, bëjnë të mundur pasurimin e metodave të mësimdhënies. Duke u nisur nga fakti që programi i studimit ka një karakter profesional dhe aplikativ, vizitat studimore pranë institucioneve të ndryshme dhe organizimi i praktikave profesionale për studentët bëjnë të mundur përfshirjen, aktivizimin e studentëve dhe praktikimin e dijeve të marrë gjatë leksioneve.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e</p>	<p>Përfshirja e projekteve dhe detyrave të kursit si pjesë e formave të vlerësimit në syllabuset e lëndëve të ndryshme, bën të mundur krijimin e sensit të autonomisë të studentët. <i>Mbetet e rëndësishme që në të ardhmen të mundësohet përfshirja e studentëve në projekte që ndihmojnë përmirësimin e imazhit të vetë institucionit. Studentët e programit Master profesional në Komunikim Publik, për nga vetë profili i studimit dhe formimi që marrin mund të japin një kontribut të rëndësishëm pranë drejtorisë së komunikimit të institucionit. Kjo</i></p>



marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<i>praktikë do të ishte me interes edhe për vetë studentët të cilët duke plotësuar detyrimet e lëndëve të ndryshme mund të ndihmojnë institucionin me projekte dhe ide të vlefshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga inspektimi që iu bë auditoreve dhe ambienteve të tjera në funksion të programit, u konstatua se procesi mësimor dhe shkencor në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike realizohet në mjedise të përshtatshme dhe të mirëpajisura. Kushtet e higjenës dhe infrastruktura në auditore dhe ambientet mbështetëse është në nivel të lartë. Kampusi i ri ofron mundësi të mira infrastrukturore për zhvillimin e veprimtarisë mësimore-shkencore. <i>Sugjerim: Në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të këtyre kushteve, është e nevojshme të shtohen hapësirat për bibliotekën.</i>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Institucioni ka dy sisteme informatike në funksion të studentëve dhe personelit akademik. Një nga sistemet është “Aula” ndërsa tjetri është sistemi “Pitagora”. Nga vlerësimi i evidencave të paraqitura për infrastrukturën, rezulton se Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike zotëron infrastrukturën e nevojshme të IT-së për realizimin e procesit mësimor. Laboratorët e kompjuterave plotësojnë kuadrin e infrastrukturës së IT-së në funksionin të programit. Institucioni kishte hasur vështirësi në garantimin e shërbimit nga kompania që ofron sistemin Aula, për shkak se kishte marrë si premtim nga RASH vënien në funksion të një sistemi të ri. Për të shmangur vonesat e krijuara institucioni nëpërmjet Bordit të Administrimit, ka marrë vendimin për të zgjatur afatin e kontratës me ofruesin e shërbimit të sistemit Aula.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Procedura e përmirësimit të literaturës është e përcaktuar qartë dhe përfshin kërkesën e lektorit për tituj dhe literaturë të re. Grumbullimi i të gjithë syllabuseve, i ofron një panoramë të qartë bibliotekës për literaturën e re që duhet të sigurohet në funksion të mbarëvajtjes së programit. Institucion ka qasje në biblioteka online përmes abonimit në databazë EBSCO. <i>Ndërkohë nga verifikimi i bërë në bibliotekën fizike, vihet re se literatura në gjuhën shqipe nuk është e mjaftueshme në fushën e komunikimit masiv dhe komunikimit publik. Nevojitet të garantohen titujt e nevojshëm në gjuhën e programit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi marrin informacionin e nevojshëm. Në veçanti duhet të shtohen numri i botimeve që shërbejnë si literaturë bazë për lëndët e formimit të përgjithshëm.</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme	

dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.					
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike ofron shërbimin e librarisë elektronike nëpërmjet abonimit në platforma si EBSCO. Studentët kanë mundësi të aksesojnë literaturën që frojnë këto databaza. Kjo databazë përfshin një sërë botimesh si Artikuj, Revista dhe Publikime. Në listën e paraqitur në evidencën nr. 82 është përcaktuar se ekzistojnë rreth 125 tituj të fushës së komunikimit dhe medias. <i>Mbetet e rëndësishme informimi i studentëve për mundësinë e librarisë elektronike dhe nxitja e tyre për të përdorur këtë burim. Në të ardhmen sugjerohet të mendohet hartimi i një manuali për përdorimin e librarisë elektronike si dhe të promovohen mundësitë e këtij burimi literature.</i>				
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Nga verifikimi në ambientet e institucionit dhe vlerësimi i evidencave të paraqitura, rezulton se studentët e masterit të komunikimit publik kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme laboratorike për realizimin e detyrimeve që kanë në secilën lënë. Laboratorët e kompjuterave të ngritur pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike garantojnë këtë mundësi. Në të ardhmen do të ishte me vlerë ngritja e një atelieje të posaçme për formimin e studentëve të komunikimit publik. Ekzistenca e një atelieje të komunikimit dhe medias do të rritë kapacitetin infrastrukturor të departamentit dhe do të përmirësojë kushtet në funksion të studentëve dhe personelit akademik.				
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Nuk u konstatua përdorim i platformave (e-learning)				
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Dokumentacioni elektronik është i aksesueshëm për studentët dhe personelin akademik nëpërmjet faqes së internetit të institucionit dhe mundësive të tjera që garanton infrastruktura e IT-së së institucionit. Nga ana tjetër Institucioni duket se ofron hapësira të nevojshme si salla, zyra, e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për aksesimin e dokumentacionit elektronik.				
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Në rregulloren e diplomimit janë përcaktuar qartë detyrat e udhëheqësit të temës së diplomimit dhe detyrimet e studentëve. Nga ana tjetër gjatë bashkëbisedimit me personelin akademik dhe drejtuesit e departamentit, doli në pah fakti se studentët ndihmohen në përzgjedhjen e temës duke iu ofruar një listë me akse studimi të mundshme. Kjo listë i orienton studentët dhe i ndihmon në përzgjedhjen e temës. Nga ana tjetër udhëheqësi këshillon, mbështet, orienton dhe asiston studentit për të zhvilluar tezën e diplomës. Në nenin 5 të rregullores së diplomimit përcaktohet se “puna për realizimin e tezës së diplomës realizohet nga studenti dhe nën udhëheqjen e personelit akademik”. Ndërkohë që neni 7 i kësaj rregulloreje përcakton kriteret e sigurimit të cilësisë dhe raportimeve gjatë procesit të hartimit të temës.				
	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përbushet</td> <td>Përbushet pjesërisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit			X	
-------------------------------------	--	--	---	--

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Aspekti i përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional, organizohet dhe drejtohet nga Nësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi duket se ka krijuar një përvojë të mirë në menaxhimin e këtij procesi. Nga biseda e realizuar me anëtarët e NJSBC-së doli në pah organizimi i detajuar i strukturave të sigurimit të cilësisë. Përveç organizimit në nivel institucioni, sigurimi i cilësisë është i organizuar edhe në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësie bazë, të cilat harmonizojnë dhe koordinojnë punën për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie. Rregullorja e NJSBC-së përcakton mënyrën e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë në nivel fakulteti dhe departamenti. Ndërkohë nëpërmjet anketimeve të kryera nga studentët dhe vlerësimit të bërë nga titullari i njësisë, personeli akademik ka mundur të rrisë shkallën e vetëdijësisë për sa i përket procesit të sigurimit të cilësisë.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja të mësimdhënies, është çështje që lidhet si me anën infrastrukturore të institucionit ashtu edhe me strategjinë e cilësisë së IAL-së. Nga mbikëqyrja e ambienteve dhe auditorëve në Fakultetin i Shkencave Politike Juridike, vihet re se zhvillimi i metodave të reja të mësimdhënies është plotësisht i mundur. Në këtë pikë, institucioni nevojitet të zhvillojë një politikë më të detajuar për trajnimin e personelit akademik. Ekzistenca e programeve në fushën e edukimit dhe teknologjisë së informacioni është një mundësi e mirë që mund të shërbejë për rritjen e shkallës së përvetësimit të metodave inovatore të mësimdhënies nga i gjithë personeli akademik. Fakulteti i Shkencave Politike Juridike duhet të fokusohet më shumë në këtë drejtim duke koordinuar më mirë punën me departamentet dhe njësitë e tjera bazë. Sa i përket trajnimit në fushën e kërkimit shkencor, më shumë rol i bie Zyrës për kërkimin shkencor dhe projektet. Është për tu vlerësuar fakti që institucioni ka miratuar “Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe njësive të UAMD” siç përmendet në evidencën nr.52.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë kanë nxitur personelin akademik për të rritur shkallën e përgatitjes duke marrë pjesë në programet e mobilitetit. <i>Megjithatë një politikë e miratuar për trajnimin e vazhdueshëm do të ndikonte pozitivisht në rritjen e cilësisë. Po kështu është e nevojshme rritja e rolit të njësive kryesore në përcaktimin e nevojave për trajnime specifike të personelit akademik. Nevoja për trajnime të stafit duhet të koordinohet mes</i>






	<i>njësive kryesore dhe njësive dhe strukturave administrative si Burimet Njerëzore dhe NJSBC.</i>			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Vihet re se personeli akademik dhe ai ndihmës akademik është i angazhuar në zbatimin e programit të studimit Master profesional në komunikim publik. Grupi i vlerësimit të brendshëm, në raportin që ka hartuar i referohet rolit të Përgjegjësit të Departamentit duke vënë theksin në rolin e tij si përgjegjësi kryesor për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë. Në këtë pikë do ishte pozitive forcimi i rolit gjithë stafit akademik duke e konceptuar personelin e departamentit si një organ kolegjal që merr vendime dhe monitoron situatën për zbatimin e programeve të studimit.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik në departament nxitet të testojë metoda inovative mësimdhënieje. Megjithatë informacioni mbi metodat e mësimdhënies merret më së shumti nga përpunimi i anketave me studentët. Në këtë pikë do të ishte e nevojshme që personeli akademik të kishte orientime më të qarta nga institucioni për metodat inavtive në mësimdhënie. Nga ana tjetër zhvillimi i një mekanizmi nxitës dhe vlerësues për ata pjesëtarë të personelit që i implementojnë këto metoda, do ndikonte pozitivisht në këtë drejtim.			
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Nga vlerësimi i evidencave, vihet re se departamenti ka krijuar një praktikë pozitive në organizimin e leksioneve të hapura me akademikë dhe profesionistë të tregut. Për këtë ka një plan vjetor aktivitetesh. Këta lektorë të ftuar ndihmojnë në realizimin e objektivave mësimorë dhe përmirësimin e procesit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5



Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga këqyrja që i është bërë evidencave konstatohet se mënyra e vlerësimit dhe e testimit të njohurive është e përcaktuar në silabusin e secilës lëndë. Rregullorja e IAL-së e përcakton formën e sillabusit dhe zërat që ai duhet të përfshijë. Ndërkohë Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike. Më konkretisht neni 54 përcakton se “forma e vetme e kontrollit të dijes në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike është provimi me shkrim. Për çdo kurs 10% e vlerësimit bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grupe, dhe esetë, sipas programit të lëndës së miratuar”. Këto forma i bëhen të ditura studentëve nga lektori i lëndës dhe janë afishuar në Web-in e universitetit, në rrjetet sociale të fakultetit dhe të afishuara pranë stendave të njoftimeve në fakultet.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen	Lektorët e lëndëve informojnë studentët për metodologjinë dhe zërat e vlerësimit të njohurive. Nga bashkëbisedimi i zhvilluar me studentë të






me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	programit Master professional në Komunikim Publik, u konstatua se studentët kishin njohuri të plota për metodat e vlerësimit dhe testimit të njohurive nga ana e lektorëve. Në nenin 56 të Rregullores së Departamentit të Shkencave Politike ka të njëjtin përcaktim për format e kontrollit të dijeve si në rregulloren e fakuletit dhe atë të institucionit.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Rregulloret e brendshme si në nivel institucional ashtu edhe në nivel të njësisë bazë dhe njësisë kryesore, përcaktojnë një formë të vetme të testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve. Sipas përcaktimit të këtyre rregulloreve, forma e vetme është provimi me shkrim, ndërsa vetëm 10% i është lënë formave të tjera si detyra e kursi, projekte individuale apo në grupe, dhe ese. Përcaktimi në një nivel të caktuar të përqindjes që zënë format e tjera të vlerësimit, mund të krijojë vështirësi për lektorët në organizimin e lëndës. Në rastin e lëndëve praktike kjo pikë e rregullores mund të përbëjë pengesë pasi e privon lektorin t'i ndajë më shumë peshë projekteve dhe zërave të tjerë të vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nak përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi i studentëve të këtij programi është i shtrirë në gjithë vitin duke patur një shpërndarje që garanton vlerësimin në mënyrë të vazhdueshme të njohurive. Studentët i nënshtrohen dy provimeve me shkrim në semester dhe një mbrojtje në detyrë kursi. Rezultatet e çdo lënde janë semestrale. Për vlerësimin e dijeve dhe aftësive profesionale, në rregulloren e Departamentit të Shkencave Politike është parashikuar që për çdo lëndë 10% e vlerësimit të bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grupe, dhe esetë.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në këtë program nuk aplikohen forma elektronike të testimit dhe vlerësimit.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	UAMD ka të parashikuar në rregulloret e brendshme ngritjen e komisioneve si për hartimin e provimeve ashtu dhe për vlerësimin e njohurive. Komisionet janë të përbëra nga tre anëtarë të stafit akademik. Titullari i lëndës është pjesë e këtyre komisionit.

<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Departamenti nuk aplikon sistem anonim me sekretim apo kodifikim për vlerësimin e dijeve të studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Rregullorja e re e UAMD-së në nenin 69, pika 7 parashikon që secili personel akademik të bëjë ballafaqimin e rezultateve të provimit e studentët dhe të shpjegojë provimin. Më konkretisht në këtë pikë thuhet se “ studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht privimin në prezencë të personelit akademik të kursit për të marrë sqarimet e duhura”. Ndërkohë lektorët janë të detyruar të japin rezultatet brenda 72 orëve.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti ka vendosur që zhvillimi i provimeve të kryet nën vëzhgimin e lektorit/komisionit të lëndës dhe me praninë e një asistenti nga personeli akademik. Në rregulloren e departamentit thuhet se “Në provim janë të pranishëm personeli akademik i lëndës (lektori dhe asistent-lektori i lëndës) ose personeli akademik i lëndës dhe personeli akademik asistues i caktuar nga Përgjegjësi i Departamentit (nëse lënda nuk ka asistent-lektor). Nëse asistuesi nuk paraqitet në provim, personeli akademik i lëndës njofton Përgjegjësin e Departamentit, i cili merr masa për zëvendësimin e tij.” Nga ana tjetër në rregullore janë parashikuar dhe procedurat që ndiqen për studentët që evindetohen se kanë kryer shkelje. Kuadri i i brendshëm rregullator i jep të drejtë personelit akademik prezent gjatë provimit që t’i ndërpresë provimin studentit duke e përcjellë më pas procesverbalin përkatës dhe vlerësimin me 0 pikë të studentit. Në kuadër të parandalimit të plagjiaturës dhe kopjimit, krahas masave ndëshkuese për shkeljen e rregullave, universiteti duhet të investojë në programe kompjuterike që përdoren për zbulimin e rasteve të plagjiaturës.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga analizimi i kuadrit rregullator për provimet dhe praktikën e vërejtura nga ekspertët gjatë vizitës në institucion, arrihet në konkluzionin se studentët e programit Master Professional në Komunikim Publik, vlerësohen në mënyrë transparente dhe koha e marrjes së rezultateve është përcaktuar qartë. Lektori i lëndës që harton tezën e provimit si pjesë e komisioneve bën edhe korrigjimin.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Rregullorja e Fakultetit ka të parashikuar procedurën për ankimimin e vlerësimit nga ana e studentit. Më konkretisht në nenin 57, pika 1, e kësaj rregulloreje studentëve i lihet një afat prej 3 ditësh nga shpallja e rezultateve për të përcjellë ankesat e tyre në lidhje me pretendimin për shkelje të rregullave të provimit dhe vlerësimit. Studenti i drejton ankesën drejtuesit të njësisë kryesore. Megjithëse rregulloret e kanë të përcaktuar qartë procedurën e ankimimit dhe hapat që ndiqen nga njësia bazë, vlen të përmendet se ka nevojë për më shumë informim të studentëve në lidhje me këtë çështje. Studentët duhet të bëhen pjesë e senceve informuese ku tu shpjegohet e drejta e kundërshtimit dhe ankimimit të notës, si dhe roli që kanë gjatë këtij procesi të gjitha njësitë. <i>Krahas kësaj do të ishte më e dobishme që studentët të</i></p>

	<i>dorëzonin ankesat e tyre në sekretarinë mësimore dhe jo direkt të drejtuesi i njësisë kryesore.</i>			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Ankesat e studentëve kalojnë nga njësia kryesore në njësinë bazë. Nëse dekani e vlerëson të arsyeshme, ia përcjell ankesën përgjegjësit të departamentit i cili më pas duhet që së bashku me lektorin e lëndës të përcjellë një relacion shpjegues për rastin. Ky relacion shërben si informacion bazë për dekanin në mënyrë që të marrë një vendim për pranimin ose jo të ankimimit. Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës nëse lënda.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Master Profesional në komunikim publik, është mjaft i ri dhe ka pak kohë që është funksional. Ky fakt e bën të vështirë një vlerësim të plotë mbi mënyrën e zhvillimit të tij dhe sesi kjo është e lidhur me garantimin e thellimit të njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale. Bazuar në planin mësimor, mund të vlerësojmë se ai garanton një thellim të njohurive për studentët si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit në përgjithësi është i organizuar në mënyrë që të ofrojë një ndarje të balancuar të njohurive. Duke qenë një program profesional që zgjat 1 vit akademik, është e vështirë që të përfshihen një numër i madh lëndësh me orientim specifik. Megjithatë në kuadër të njohurive që lidhen me fushën e teknologjisë së informacionit, sugjerohet të shtohen lëndë në planin mësimor. Këto lëndë mund të jenë në formën e lëndëve me zgjedhje për t'u krijuar mundësi studentëve që të marrin njohuritë profesionale në këtë fushë. Një lëndë si "aplikacione multimediale" mund të ishte e dobishme për studentët.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Lektorët në këtë departament treguan se kanë një angazhim të plotë për të përmirësuar syllabuset e lëndëve në mënyrë periodike. Ata bëjnë ballafaqimin e mungesës së aftësive të studentëve dhe objektivave që kanë përcaktuar në syllabus duke i reflektuar ato në semestrin tjetër. Megjithatë për të vlerësuar shkallën e analizës që bëhet nga secili lektor dhe për të rritur shkallën e transperencës përballë studentëve, mund të jetë e nevojshme publikimi i syllabuseve të secilës lëndë për 5 vitet e fundit, ose edhe më pak, në Web-faqen e departamentit.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Nga bashkëbisedimi me studentët e këtij programi u konstatua se lektorët ishin të gatshëm të orientojnë studentët përpara provimeve përfundimtare të ç' do lënde. Lektorët në orën e fundit mësimore, ndajnë me studentët konceptet dhe temat më të rëndësishme të lëndës.

Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga analizimi i raportit të vlerësimit të brendshëm dhe dokumentave të tjera shoqëruese, veçanërisht planit të aktiviteteve dhe evidencave të tjera, vihet re një praktikë pozitive e Departamentit të Shkencave Politike në organizimin e leksioneve dhe forumeve të hapura me specialistë ose ekspertë të fushave që lidhen me profilin e programit Master Profesionak në Komunikim Publik.			
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Departamenti i Shkencave Politike ka mundësi të përdorë insfraturën laboratorike që ekziston në njësinë kryesore për të ndihmuar studentët e këtij programi studimi për të zhvilluar njohuritë e tyre. Megjithatë nisur nga profili i vetë programit, është e nevojshme investimi në një insfraturë laboratorike më specifike në fushën e komunikimit dhe medias.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Kolegjialiteti në njësinë bazë garantohehet përmes diskutimeve në mbledhjet e anëtarëve të stafit akademik. Nga diskutimi i bërë me stafin akademik, u vu re se departamenti ka një praktikë të rregullt të mbledhjeve dhe diskutimit të çështjeve që kanë lidhje me mbarëvajtjen e programeve të studimit.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Politikat për personelin, sidomos pjesëmarrja në programet e shkëmbimit dhe angazhimi në projekte të ndryshme tregojnë se lidhshipi i universitetit në të gjitha nivelet ka një qasje aktive në nxitjen e stafit akademik për zhvillimin e ideve inovative dhe aplikimin e tyre në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga analizimi i evidencave dhe bisedat e zhvilluara me personelin akademik dhe studentët, rezulton se organizimi i konferencave studentore është një tregues konkret për nxitjen dhe përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor. Politika e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike si dhe Departamentit të Shkencave Politike mbështet në organizimin e aktiviteteve të kërkimit shkencor ku mund të përfshihen edhe studentët.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Praktika e mobilitetit të studentëve parashikon një vlerësim të kurrikulave të institucioneve dhe programeve pritëse. Njësitë përgjegjëse zhvillojnë një komunikim të hapur me studentët e interesuar për tu përfshirë në këto programe shkëmbimi. Marrëveshjet bashkëpunuese që janë lidhur me institucione të tjera bëjnë të mundur për studentët realizimin e mobilitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë	Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në listën e evidencave për sa i përket infrastrukturës, arrijnë në përfundimin se studentët e programit Master Professional në Komunikim Publik, kanë në dispozicion një

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

33

mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	infrastrukturë të përshtatshme për të marrë dhe praktikuar njohuritë e tyre. Praktikrat profesionale realizohen më shumë nëpërmjet bashkëpunimit me institucione publike dhe private. Për të rritur mundësitë në dispozicion të studentëve, mund të jetë e nevojshme krijimi i hapësirave për realizimin e praktikës profesionale brenda institucionit. Hapja e programeve të intershipit nga njësitë administrative brenda universitetit mund të jetë një alternativë e dobishme.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ndonëse Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike ka programe për praktika klinike, ndër të cilat mund të përmendet Klinika e Ligjit, këto njësi shërbejnë më shumë për programet juridike dhe jo për studentët e masterit profesional në komunikim publik.			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale është pjesë e planit mësimor të programit dhe zhvillohet në semestrin e dytë. Praktika profesionale ka 6 kredite. Realizimi i praktikës profesionale është e detyrueshme për studentët. Megjithatë nga vizita dhe diskutimet e bëra me stafin e programit, u vu re se praktika profesionale zhvillohet gjatë muajve të verës, pasi studentët kanë përfunduar detyrimet e lëndëve të tjera. Kjo praktikë e ndjekur bashkë me ngarkesën e madhe të krediteve që studentët kanë në semestrin e dytë, e vështirëson procesin e diplomimit të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Procedura për diplomimin e studentëve është parashikuar në rregulloren e diplomimit dhe në udhëzuesin “Për studentët që kërkojnë të diplomohen në “master shkencor” & “master profesional”. Udhëzuesi fillon me rregulat për realizimin e praktikës profesionale dhe mikrotezës. Në rastin e praktikës profesionale, studentët janë të detyruar të marrin praktikën pasi kanë përmbushur me sukses detyrimet në të gjitha lëndët e tjera të programit. Vendosja e këtij parakushti për një program studimi një vjeçar, mund të mos jetë e përshtatshme pasi ai sjell vonesa në realizimin e programit dhe shtyn diplomimin e studentëve përtej dy semestrave. Ndërkohë që praktika profesionale, është ekuivalent me një lëndë tjetër me 6 kredite dhe ska pse të trajtohet ndryshe duke mos u realizuar paralelisht me lëndët e semestrit të dytë. Procedura e diplomimit i bëhet e ditur studentit në semestrin e fundit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion	“Për studentët që kërkojnë të diplomohen në “master shkencor” & “master profesional” krijon një bazë të mirë informacioni për orientimin e studentëve në lidhje me përmbylljen e detyrimeve të

informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	programit. Nga ana tjetër strukturat në nivel njësi kryesore dhe njësie bazë, së bashku me sekretarinë mësimore për Ciklin e Dytë të Studimeve, angazhohen për të ndihmuar studentët në fazën e pare të aplikimit për tezë diplome, dhe në fazat e tjera përmbyllëse.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Studentët e këtij programi studimi realizojnë mbrojtjen e diplomës nëpërmjet tezës së diplomës.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Nga diskutimet që grupi i ekspertëve realizoi me GVB-në dhe stafin akademik të programit u konstatua se personeli akademik është i angazhuar në orientimin e studentëve për përzgjedhjen e temës së tezës. Stafi harton një listë me akset kryesore të studimit duke ia vënë në dispozicion studentëve, të cilët më pas bazuar në këto akse të përgjithshme, kanë mundësi të zgjedhin një temë specifike për tezën e tyre. Ndërkohë rregulloja e diplomimit përcakton se udhëheqësi shkencor është përgjegjësi kryesor për përzgjedhjen e temave dhe këshillimin apo mbikqyrjen e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së tezës.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Përgjegjësia kryesore për mbikqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së tezës, është e udhëheqësit. Është pikërisht udhëheqësi ai që ndihmon studentët edhe për nevoja të veçanta që duhen mundësuar nga institucioni, në kuadër të përgatitjes me sukses së tezës.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi shkencor ka një rol të rëndësishëm në procesin e përgatitjes së tezës. Në bazë të vlerësimit të bërë te kuadrit rregullator të brendshëm roli i udhëheqësit është i mirëpërcaktuar. Ndërkohë nga diskutimet e bëra me grupin e studentëve përfaqësues të të diplomuarve, u konstatua se studentët që kishin kaluar nga procesi i tezës, ishin në dijeni për rolin dhe mbështetjen e udhëheqësit shkencor.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Rregullorja e diplomimit në nenin 11 të saj ka përcaktuar mënyrën e vlerësimit të tezës së diplomës. Në pikën 1 të këtij neni përcaktohet se vlerësimi “bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga departamenti përkatës dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë.”
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studentët që përmbyllin me sukses detyrimet e programit, përfshi edhe tezën e diplomës, pajisen me diplomën përkatëse. Nga verifikimet e bëra nga grupi i ekspertëve pranë sekretarisë mësimore, u vunë re disa problematika në pajisen e studentëve me diplomë. Në sekretarinë mësimore u evidentua rasti i një studenti që kishte përfunduar studimet duke përmbushur të gjitha detyrime, por që ende nuk ishte pajisur me diplomë për shkak se i mungonte numri i matrikulimit. Është më rëndësi që drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore të marrin masat e nevojshme për të ndjekur këtë problematikë dhe për të ofruar zgjidhjet e nevojshme.
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në	Institucioni i mundëson studentëve, krahas diplomës dhe suplementit, marrjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm shoqërues.



dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.				
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Institucioni ka një procedurë të përcaktuar qartë për ruajtjen e dokumentacionit. Rregullorja për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit në nenin 27 dhe 28 ka përcaktuar kushtet e ruajtjes së dokumentave dhe vënien në dispozicion në rastet kur kërkohen nga ana e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për të dhënat e personelit akademik, është Zyra e Burimeve Njerëzore e cila, mbledh ruan dhe përditëson në një dosje të posaçme të dhënat për secilin nga anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës ekonomik. Nga verifikimi i bërë në zyrën e burimeve njerëzore, për dosjet e personelit akademik, u vu re që ajo ishte e përditësuar me të gjitha kualifikimet e fundit akademik, arrijtet në fushën e kërkimit, publikimit dhe elementë të tjerë që përfshijnë kualifikimin e vazhdueshëm lektorit.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit të personelit akademik, janë të përcaktuara në bazë të kërkesave specifike të nënsive bazë, duke mbajtur parasysh natyrën e programit të studimit dhe ngarkesën mësimore që duhet të mbulohet. Kriteret janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Gjatë vizitës në institucion , grupi i ekspertëve të jashtëm kërkoi dokumentacionin që tregonte një praktikë rekrutimi për personelin akademik. Nga verifikimi i bërë shkruar me nr.474 të datës 9.8.2018 të dërguar Drejtorisë së Burimeve njerëzore nga Fakulteti i Biznesit, vihet re se njësia kryesore ka përcaktuar numrin e personelit akademik më kohë të pjesshme dhe kriteret specifike që një kandidat duhet të plotësojë.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Neni 26 i rregullores së UAMD-së përcakton procedurën dhe hapat për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë. Më konkretisht, në këtë nen thuhet se “Punësimi realizohet me procedurë të konkurimit të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik dhe ndihmës mësimorshkencor, propozohen nga departamenti përkatës. Dekani pasi i verifikon paraprakisht dhe i miraton në Këshillin e Fakultetit, i përcjell për ndjekje të mëtejshme, të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës”. Ndërkohë neni 27 i kësaj rregulloreje përcakton kushte për rekrutimin i personelit ndihmës mësimor-shkencor. Nga verifikimi i bërë praktikave të rekrutimit në dosjen e një prej anësorëve të personelit akademik, të angazhuar në programin master profesional në komunikim publik, vihet re se procedurat dhe kriteret janë në përputhje me aktet rregullatore.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe</p>	<p>Institucioni aplikon procedura dhe vlerësimi mbështetur në specifikat dhe nevojat e programeve të studimit. Në këtë pikë, bazuar në</p>



<p>vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>rregulloren e UAMD, këshilli i fakultetit ka një rol të rëndësishëm. Ky këshill miraton kriteret dhe procedurët për rekrutimin e personelit akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Vihet re se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, ka krijuar mjedis të përshtatshëm dhe mundësi të barabarta për personelin akademik. Grupi i ekspertëve të jashtëm, gjatë vizitës në institucion dhe bashkëbisedimit me personelin akademik të Departamentit dhe atij të angazhuar në ralizimin e programit Master Profesional Komunikum Publik, konstatoi se anëtarët e trupës akademike kanë informacionin e nevojshëm për mënyrën sesi kryet procesi i matjes së performancës së tyre. Po kështu anëtarët e personelit akademik demonstuan njohuri të kënaqshme për procesin e rekrutimit të personelit akademik nga ana e UAMD-së. Institucioni ka të përcaktuar në rregulloret e tij te brendshme procedurën e selektimit dhe rekrutimit të personelit akademik dhe personelit ndihmës.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Nga analiza e evidencave dhe konstatimet e bëra gjatë vizitës së gripit të ekspertëve të jashtë në institucion, arrihet në përfundimin se personeli akademik i angazhuar në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës është i përfshirë në programe të kualifikimit të vazhdueshëm. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për zhvillimin akademik e profesional të personelit akademik, si edhe të atij ndihmës e administrativ në Njësinë Kryesore, si edhe në njësinë bazë të programit përgjegjës bazuar. Në Rregulloren e Re UAMD dhe në statutin e institucionit i është kushtuar një rëndësi kualifikimit të stafit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në politikat e kualifikimit dhe trajnimit të stafit është e përfshirë dhe aftësimi në drejtim të përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies dhe teknologjive të reja. Në këtë pikë është e nevojshme që institucioni përmes Zyres së Burimeve njerëzore të hartojë plane konkrete në nivel të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, në lidhje me aftësimin e vazhdueshëm të personelit akademik. Vihet re që Zyra e Burimeve Njerëzore është e kufizuar vetëm në funksionin e menaxhimit të dokumentacionit të personelit akademik dhe procedurat që lidhen me selektimin dhe rekrutimin e tij. Në funksionin të rritjes së cilësisë së stafit akademik, është nevojshme që kjo zyrë në bashkëpunim të</p>



	ngushtë me njësinë përkatëse për sigurinë e cilësisë të marrë më shumë iniciativë dhe rol aktiv në planifikimin dhe realizimin e trajnimeve të personelit akademik.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Angazhimi i personelit akademik në realizimin e planit mësimor bëhet duke mbajtur parasysh kriteret ligjore për mbulimin e ngarkesës mësimore. Departamenti i Shkencave Politike ka bërë një shpërndarje optimale të ngarkesës mësimore bazuar në profilin akademik të personelit. Do të ishte e nevojshme një politike për zgjerimin e personelit akademik me ekspertizë në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. Kjo do të bënte të mundur rritjen e peshës së personelit akademik efektiv në realizimin e ngarkesës mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga verifikimi i bërë në ambientet e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike konstatohet se kjo njësi kryesore ofron kapacitetet e nevojshme fizike për realizimin e veprimtarisë mësimdhënëse. Godina është e pajisur me mjedise të mjaftueshme mësimore, ai auditorë dhe laboratorë në dispozicion të departamentet dhe programeve të studimit. Auditorët janë të ndarë në bazë të grupeve të studentëve duke mundësuar zhvillimin qoftë të leksioneve ashtu edhe të detyrimeve seminarike.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Grupi i ekspertëve të jashtëm pas verifikimit të auditorëve dhe ambienteve të tjera në Fakultetin të Shkencave Politike Juridike, konstatoi se kjo njësi bazë disponon mjedise të pajisura me mjetet e nevojshme në mënyrë që të shfrytësohet teknologjia bashkëkohore në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në auditorë gjenden projektorët, PC dhe lidhje interneti ç'ka mundëson plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.

<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ofron më shumë se një laborator të teknologjisë së informacionit të pajosur me programe profesionale sipas natyrës së programeve që ofron. Më konkretisht në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike disponon ambientet laboratorike që mund të shfrytëzohen edhe nga studentët e Programit Master Profesionit në Komunikim Publik.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Departamenti i Shkencave Politike sa i përket praktikave profesionale ka ndërtuar bashkëpunime me institucione të tregut dhe organizma publike në nivel lokal apo kombëtar në mënyrë që tu bëjë të mundur studentëve zhvillimin e praktikave. Në kuadër të rritjeve të kapaciteteve të brendshme për zhvillimin e praktikave profesionale, sugjerohet të mendohet angazhimi i studentëve në praktika pranë zyrave administrative. Në rastin e studentëve të programit master profesional në komunikim publik, një mundësi e mirë është angazhimi i tyre në kuadër të promovimit të imazhit institucional dhe menaxhimit të kanaleve të komunikimit me publikun.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë bibliotekën pranë Fakultetit të Shkencave Politike- Juridike. Biblioteka e Fakultetit, është në dispozicion të studentëve dhe garanton mundësinë e shfrytëzimit dhe akses për të gjithë studentët, që ndjekin programet e studimit në FSHPJ. Studentët mund të shfrytëzojnë edhe librarinë elektronike nëpërmjet abonimit në platforma si EBSCO. Nga verifikimet bëra pranë ambienteve të bibliotekës u vu re se ajo ishte transferuar në një ambient të ri duke qenë ende në një fazë organizimi. Mbetet e nevojshme shtimi i titujve në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka disponon literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe në atë angleze. Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës u konstatua prezenca e periodikëve shkencorë që botohen nga universiteti. Biblioteka gjithashtu arkivon tezat e masterit të përgatitura nga studentët duke krijuar një databazë të gjerë të punimeve shkencore që mund të shfrytëzohet në vijimësi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët,</p>	<p>Nga analiza e evidencave të paraqitura vihet re se institucioni u garanton studentëve akses në librarinë elektronike nëpërmjet abonimit në platforma si EBSCO. Studentët kanë mundësi të aksesojnë literaturën që ofrojnë këto databaza. Kjo databazë përfshin një sërë</p>

në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	<p>botimesh si artikuj, revista dhe publikime. Kushtet e për grantimin e aksesit të studentëve në këtë platformë janë të përcaktuara në rreguloren e bibliotekës. Gjithashtu sipas informacionit të publikuar në faqen zyrtare në internet të institucionit, biblioteka ofron akses edhe në databaze si më poshtë:</p> <p>Akses në bloomsburycollections, për periudhën 2015-2016 Katalogu Botëror WorldCat http://www.worldcat.org/ Katalogu i Bibliotekës Britanike http://catalog.bl.uk/ Katalogu i Bibliotekës së Kongresit Amerikan http://catalog.loc.gov/Index Translationum http://databases.unesco.org/xtrans/xtraform.shtml Katalogu përmbledhës i bibliotekave të Francës – ÇFr http://çfr.bnf.fr/portailçfr/servlet/LoginServlet Në faqen zyrtare është e publikuar edhe lista e periodikëve që vijnë rregulloisht në bibliotekën e institucionit.</p>			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e Fakultetit që është në dispozicion edhe te studentëve të programit master profesional në komunikim publik, ka një hapësirë të hapur dhe infrastrukturë teknologjike të nevojshme për shfrytëzimin e materialeve.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni ka një plan financiar që prashikon zërat për pasurimin e bibliotekës. Këto të dhëna janë të paraqitura në tabelën me të dhënat financiare mbi koston e Programit të studimit.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Institucioni ka planifikuar oraret e funksionimit të bibliotekës në mënyrë që të përshtaten me nevojat e studentëve. Nga bisedat e zhvilluara me përfaqësues të bibliotekës dhe nga kqyrja e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga përfaqësues i drejtëgjorë së kurrikulave, u konstatua se institucioni ka organizuar punën e punonjësve të bibliotekës në orare që përfshinë edhe fundjavën në mënyrë që tu shërbenet edhe studentëve të programeve master që zhvillojnë leksionet në këto ditë të javës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me	Zyra e Komunikimit Alumnit dhe Karrierës, sekretaria e Fakultetit të Shkencave Politike -Juridike, si edhe Njësia Bazë, përgjegjëse për programin e studimit, janë organizmat përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave dhe informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

41

studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	akademik gjatë gjithë ciklit të studimit. Sistemi i brendshëm i menaxhimit ofron të dhëna që vijnë nga anketimet e studentëve, dhe ecitura akademike e tyre.			
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga verifikimet e bëra pranë zyrës së burimeve njerëzore, në kuadër të vizitës së ekspertëve pranë ambienteve të institucionit, u konstatua se kjo njësi administrative mbledh dhe administron gjithë informacionin që lidhet me personelin akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit ofron një zonë aksesi si për studentët ashtu edhe për personelin akademik. Studentët dhe stafi mund të aksesojnë dokumentacionin e kërkuar përmes llogarisë së tyre elektronike. Në faqen zyrtare të institucionit në internet, në kuadër të shëbrimeve është ofruar mundësia e futjes në sistem përmes të dhënave sic është numri i matriculimit që disponin çdo student.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Institucioni ka në dispozicion aktualisht dy sisteme menaxhimi të cilat i vijnë në ndihmë studentëve dhe personelit, duke u mundësuar forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbim të informacionit. Më konkretisht IAL-ja, pas një eksperience të mëparshme të përdorimit të platformës "Pitagora" ka rinovuar kontratën duke vazhduar marrjen e shërbimeve nga kjo platformë. Nga ana tjetër sistemi Aula është një tjetër mundësi që u vjen në ndihmë studentëve dhe personelit akademik. Sistemi Pitagora bën të mundur transmetimin e vlerësimit të dijeve të studentëve nga lektori te studenti në konfidencialitet dhe transparencë të plotë. Ndërkohë për të rritur mundësitë e komunikimit interaktiv mes studentëve dhe personelit akademik, shfrytëzohen dhe rrjetet sociale dhe faqja zyrtare e institucionit në internet.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Të dy sistemet e menaxhimit ofrojnë mundësi për të monitoruar aktivitetin akademik dhe administrativ, duke mundësuar nxjerrjen e raporteve sipas nevojave të organeve drejtuese të institucionit.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	UAMD ka një webiste mjaft të plotë me informacion dhe që përditësohet rregullisht. Website www.uamd.edu.al përmban informacione të përditësuara mbi personalin akademik, programet e studimit, aktivitete, njoftime në gjuhën shqipe dhe atë angleze, rregulloret, udhëzimet dhe njoftime në lidhje procedura të ndryshme për studentët dhe të interesuar nga publiku i gjerë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.				



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Vlerësimi i evidencave të paraqitura dhe analizimi i të dhënave në raportin e vlerësimit të brendshëm na jep mundësi të arrijnë në përfundimin se Institucioni harton raporte financiar për kostot e programit të studimit që në fazën e kërkesës për licensimit. Më pas njësitë përkatëse hartojnë raporte dhe planit për mbështetjen financiare si dhe buxhetin vjetor për nësitë bazë. Plani parashikon specifika për nevojat për literaturë të re dhe aspekte të tjera infrastrukturore të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore shërbim të realizimit të programit shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor shpenzimet për bibliotekën, pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiarë grantet vendëse apo të huaja përfituara dhe kontratat e shërbimeve lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjera sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Institucioni ka përfshirë në formatin e planit të financimit të programit elementet që lidhen me shpenzimet operative, burimet njerëzore, orët mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, shpenzimet e ndryshme operative, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni organizon procesin e auditimit të përvitshëm për vlerësimin e dokumentacionit dhe gjendjes financiare. Të dhënat dhe rezultate të auditimit janë pasqyruar në raportin i Veprimtarisë Audituese për periudhën 2013-2018.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Raportet e auditimit prezantohen për periudhën 5 vjeçare. Raporti për periudhën 2013-2018 i paraqitur në evidencën nr. 93 përmban të dhënat për periudhën e kaluar të një cikli studimi, si dhe planifikimin e të ardhmes së programit në kuadër të qëndrueshmërisë financiare.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Raportet e auditimit japin të dhëna të nevojshme për të vërtetuar qëndrueshmërinë e financiare të programit të studimit. Nga të dhënat e analizuar në këtë raport konstatohet se UAMD siguron qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për gjenerimin e të ardhurave gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe për të ardhmen. Në këtë pikë mbetet për tu parashikuar në planet financiare edhe impakti i politikave shtetërore mbi tarifat e programeve të studimit në ciklin e parë dhe të dytë, si dhe politikën e bursave për studentët.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

43

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Vlerësimi i dokumentacionit shoqërues të raportit të vetëvlerësimit dhe konstatimet e grupit të ekspertëve të jashtëm, tregojnë se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka një kuadër të plotë me politikatat dhe procedurat që lidhen me ecurinë akademike të ciklit të dytë të studimeve. Hierarkia e dokumentacionit nis me Statutin e UAMD-së, ku janë të përcaktuar format e studimit dhe procedurat e pranimit. Neni 57 i Statutit të ri të UAMD-së parashikon dy forma studimi, studime me kohë plotë dhe studime me kohë të zgjatur. Ndërkohë që për pranimin e studentëve është parashikuar ngritja e komisioneve <i>ad hoc</i> . Aktet e tjera rregullatore që mbështeten në statutin e universitetit detajojnë këto procedura. Plani strategjik 5 vjeçar i hartuar nga IAL-ja ka përcaktuar politikatat strategjike të zhvillimit të institucionit ku përfshihen dhe objektivat në lidhje me pjesën akademike.
Kriteri 2. Politikatat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikatat dhe procedurat që Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka hartuar dhe miratuar në vijimësi, garantojnë kushtet e barazisë për kandidatët për studentë dhe studentët aktualë. Procedurat e pranimit dhe ato të diplomimit, të parashikuara në aktet e brendshme rregullatore, janë në përputhje me kriteret që ka parashikuar ligji i “për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e tjera nënligjore.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht	Universiteti ofron një shkallë transparence të kënaqshme për të gjitha procedurat dhe aktet që lidhen me pranimin, përzgjedhjen, procesin akademik, transferimet, njohjen e studimeve të mëparshme dhe vlerësimit të dijeve. Faqja në internet e universitetit është përditësuar rregullisht dhe ofron një informacionin më të rëndësishëm për studentët. Gjithashtu në këtë faqe ka seksione të veçanta ku bëhen publike vendimet e organeve kolegjiale, si senati akademik, dhe bordi i administrimit. Nga vëzhgimi i bërë në faqen e internetit, duket se publikimi i vendimeve bëhet në mënyrë të rregullt. Ndërkohë që faqja

të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	ka të publikuar dokumentacion dhe informacione të nevojshme për ecurinë akademike të studentëve, si dhe marrjen e shërbimeve nga njësitë e IAL-së. UAMD, ka të miratuar gjithashtu edhe programin e transparencës, duke përbushur një detyrim ligjor që buron nga ligji për 119/2014“ Për të drejtën e informimit”. Gjatë vizitës se ekspertëve të jashtëm në institucion u konstatua prania e këndeve të informimit të studentëve në ambientet e godinës si dhe kuti të posacme për formularët dhe dokumentacionin që nevojitet për të marrë shërbime pranë njësie të caktuara të IAL-së.								
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Kriteret e veçanta për pranimin e studentëve publikohen çdo fillim viti akademik në faqen zyrtare në internet dhe afishohen në ambientet e kampusit universitar. Në vendimin e fundit nr. 4 të dekanatit pranë Fakultetit të Shkencave Politike - Juridike, që mban datën 4.2 2019 janë përcaktuar kushtet dhe kriteret që një student duhet të përbushë për tu regjistruar në programin Master Profesional në Komunikim Publik.								
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Universiteti ka një politike të mirë promovimi për programet e studimit që ofron. Komunikimi me maturanët në kuadër të këshillimit të karrierës funksionon mjaft mirë dhe ofron informacion i dobishëm për ata që duan të studiojnë në programet e këtij institucioni. Kandidatët për studentë, familjarët e tyre dhe publiku i gjerë ka mundësi të informohet përmes kanaleve të komunikimit të IAL-së. Përdorimi i hapësirës dixhitale ku përfshihet faqja zyrtare në internet dhe llogaritë zyrtare në median sociale, ndihmon në informimin e personave të interesuar dhe në rritjen e shkallës së transparencës.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Përparimi akademik i një studenti është i përcaktuar në disa rregullore të miratuara nga universiteti. Në rregulloren e programit Master Profesional në Komunikim Publik, në nenin 23 përcaktohen procedurat dhe kriteret e vlerësimit. Më konkretisht në këtë nen përcaktohet nota kaluese që duhet të marrë një student në një lëndë të caktuar.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Institucioni ka të përcaktuar në aktet rregullatore, procedurën dhe kriteret e njohjes së studimeve apo kualifikimeve të mëparshme. Në rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike, në nenin 34, pika 4 thuhet se “Fakulteti i Shkencave Politike Juridike mund t’u njohë studentëve kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit “Master i shkencave”. Vlerësimi do të bëhet bazuar në përputhshmërinë midis kurrikulës së programit “Master profesional” dhe asaj të “Master të shkencave”, sipas përcaktimeve të përmbytura në

	Rregulloren e transferimeve. Ndërsa në nenin 42, pika 3 dhe 4 përcaktohen kriteret për njohjen e kualifikimeve të mëparshme. Më konkretisht në këtë nen thuhet se “ Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë për transferimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kreditet minimale të domosdoshme për transferimin e studimeve janë 30 kredite të fituara. Numri maksimal i krediteve të njohura për programet e studimit në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve përcaktohen në aktet nënligjore në fuqi”			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Vlerësimi i dijeve bëhet bazuar në përcaktimet e vendosura në sillabusin e çdo lënde dhe kriteret e përcaktuara në rregulloren e Provimeve në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, Rregulloren e Mikrotezës në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike dhe në Rregulloren e Tezës së Diplomës në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike. Studentët njihen me kriteret dhe procedurat e vlerësimit që në javën e parë të çdo lënde kur lektori prezanton programin e lëndës.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Informacioni mbi procesin e punimit të diplomës, që nga faza e përzgjedhjes së temës, mbikqyrjes nga ana e supervizorit dhe deri në fazën e mbrotjes, është i pasqyruar në Rregulloren e Diplomimeve në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Njësitë bazë në UAMD janë të përfshira në informimin e kandidatëve për studentë për mundësi e studimit në këtë institucion. Ndërkohë që në rang institucional, publikohen në faqen zyrtare të internetit, detajet për kriteret e pranimit në programet e studimit, stafi akademik për secilin department si dhe planet mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Në Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës studentët marrin informacion për strukturën e programit të studimit dhe kohëzgjatjen përmes publikimit të planeve mësimore dhe kurrikulave për secilin program studimi në faqen zyrtare në internet dhe nëpërmjet aksesit që studentët kanë nga sistemi i brendshëm të menaxhimit institucional. Nga këqyrja e evidencave konstatohet se njësitë bazë, organizojnë takime informuese për studentët për ti njohur këta të fundit me programet e studimit, sistemin e vlerësimit dhe aspekte të tjera të ecurisë akademike. Një takim që duket se është praktikë e rregullt në UAMD është takimi i çdo fillim viti akademik, ku njësia bazë informon dhe orienton studentët, për të gjithë elementet e programit të studimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



46

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion /udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Kanali kryesor i informimit të studentëve në UAMD mbetet faja zyrtare në internet. Studentët kanë mundësi që përmes publikimeve në web, të informohen për lëndët, modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>Studentët nuk kanë pengesa për tu njohur me Planin Mësimor në MP Komunikim Publik. Megjithatë për të rritur transparencën ndaj studentëve për sa i përket detajeve të programit të studimit, sugjerohet që të krijohet një seksion i veçantë në faqen zyrtare në web, ku të jenë të publikuara të gjitha rregulloret dhe udhëzimet e brendshme, në nivel institucional, nivel njësie kryesore dhe njësie bazë. Kjo praktikë do të lehtësonte gjetjen e informacionit, dhe njohjen me procedurat për çdo proces që lidhet me mbarëvajtjen akademike.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Roli i zyrës së Këshillimit të Karrierës duhet të bëhet më i njohur për studentët. Kjo zyrë ka përgjegjësinë kryesore për të informuar dhe orientuar studentët për mundësitë e praktikavë mësimore, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe mbi mundësitë të punësimit. Megjithatë nga takimet e zhvilluara me studentë u konstatua se ata kanë pak informacion si funksionon zyra e këshillimit të karrierës. Studentët e diplomuar pranuan se në shumicën e rasteve, ata i kanë arritur të sigurojnë praktika profesionale përmes ndihmës së lektorëve dhe me anë ta njohjeve të tyre. Duke patur parasysh faktin se UAMD është një institucion i madh dhe programet e studimit që ofron kanë specifika që ndryshojnë ndjeshën nga njëri-tjetri, kjo zyrë e ka të vështirë të ofrojë mbështetje për të gjithë studentët. Në këtë pikë do ishte e dobishme që njësia bazë të merrte më shumë rol në këshillimin e karrierës. Për të bashkërenduar më mirë punën me zyrën përkatëse dhe për ti ardhur në ndihmë studentëve, caktimi i një këshilltari për karrierën në departament është një hap i këshillueshëm. Lекtori përgjegjës për këshillimin e karrierës do të luajë një rol koordinues mes departamentit dhe zyrës, duke bërë të mundur përcjelljen nevojave specifike të studentëve dhe koordinimin e aktiviteteve formuese.</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Kanalet tradicionale dhe ato dixhitale të komunikimit të përdorura nga struktura akademike dhe njësitë administrative, ofrojnë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe shërbimet përkatëse. Studentët njoftohen përmes emailit, publikimeve në faqen zyrtare në internet, publikimet përmes llogarive zyrtare në rrjetet sociale dhe afishimit të njoftimeve dhe vendimeve të ndryshme në ambientet fizike të institucionit.</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, “Aula” dhe “Pitagora” ndihmojnë procesin informimit të studentëve. Aksesimi i këtyre sistemeve është i mundur edhe në distancë. Studentët kanë mundësi të logohen nga çdo vend duke marrë shërbimin e kërkuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.4				
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm				
Kriteret		Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.		Njësitë administrative ku bën pjesë Zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Shkencave Politike -Juridike janë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave vjetore për numrin e studentëve aktual dhe studentëve të diplomuar nga programet e ndryshme të studimit. <i>Gjatë vizitës së ekspertëve të jashtëm pranë institucionit dhe inspektimit në zyrën e sekretarisë mësimore, u vunë re disa mangësi sa i përket ruajtjes së të dhënave për studentët dhe të diplomuarit. Mungesa e regjistrave të printuar për programin Master Profesional në Komunikim publik, mbetet shqetësuese. Institucioni duhet të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me institucionet përkatëse shtetërore të sigurojë regjistrat.</i>		
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.		Departamenti i Shkencave Politike përgatit raport vjetor mbi ecurinë e programeve të studimit që janë pjesë e kësaj njësie. Sipas raportit të vitit 2018-2019 të hartuar, gjenden të dhëna të detajuara për kuotat e pranimit në programet e studimit të nivelit të parë dhe të dytë, numri i studentëve të pranua dhe numri i studentëve të çregjistruar. Në bazë të të dhënave vihet re se për vitin akademik në fjalë, për programin master profesional në komunikim publik, ka 11 studentë të regjistruar dhe asnjë të çregjistruar. Të dhënat që paraqiten në raportet vjetore përpunohen dhe përditësohen nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike.		
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.		Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës disponon infrastrukturën e nevojshme për të gjeneruar të dhëna rreth ecurisë akademike deri në fazën e diplomimit. Sistemi elektronik i menaxhimit ofron një bazë të rëndësishme të të dhënave në këtë drejtim. Nga ana tjetër Departamenti i Shkencave Politike Juridike i zotëron këto të dhëna duke aksesuar materialet e Sekretarisë mësimore.		
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.		Sistemi i brendshëm të informacionit bën të mundur menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, duke respektuar konfidencialitetin dhe duke lejuar verifikimin e tyre në kohë reale prej personave të autorizuar bazuar në përcaktimet e rregulloreve dhe udhëzime të mirtuar nga institucioni.		
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve		Raportet periodike janë pjesë e raportimit njëjësive bazë në koordinim me Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës dhe Njësinë e brendshme të Sigurimit të Cilësisë përpilon të dhëna tabelare në mënyrë të vazhdueshme për profilet, cilësinë dhe formimin e studentëve në hyrje dhe në dalje, duke analizuar e diskutuar mundësitë e përmirësimit të tyre. Në këtë pikë roli i Zyrës së Këshillimit të Karrierës duhet të forcohet në mënyrë që ajo të ketë informacion të detajuar për punësimet e studentëve dhe më pas ti ofrojë ato në formën e raporteve analitike të detajuara. Departamenti i Shkencave Politike Juridike, duhet që raportimin vjetor ta detajojë më tepër duke përfshirë të dhëna të detajuara dhe analiza për këto zëra.		
		Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht
				Përbushet plotësisht






Shkalla e përmbushjes së standardit			X	
-------------------------------------	--	--	---	--

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse parashikohet në statutin e IAL-së, konkretisht në nenin 14, pika 7, ku flitet për përbërjen e senatit akademik. Sipas përcaktimit në këtë pikë në senat marrin pjesë dy përfaqësues të studentëve. Krahas parashikimeve të statutit, në rastin e Fakultetit të shkencave politike Juridike, është e përcaktuar në rregullore organizimi i studentëve në kuadër të këshillit studentor. Në nenin 84 kësaj rregullorje thuhet se "Këshillat e studentëve kanë mandat 2-vjeçar dhe anëtarët e tyre zgjidhen nga votat e të gjithë studentëve të njësisë kryesore". Megjithatë përfaqësimi i studentëve sugjerohet të garantohet dhe institucionalizohet edhe në nivel të organeve kolegjiale të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike në nenin 15 ku përcaktohet përbërja e Dekanatit, nuk parashikon përfaqësimin e studentëve.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga analiza e kuadrit të brendshëm rregullator konstatohet se Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, garanton pjesëmarrjen e studentëve në organet vendimmarrëse në nivelin optimal duke përmbushur kushtet bazë ligjore. Megjithatë ky përfaqësim duhet të zgjerohet edhe në nivelet e njësisë bazë dhe njësisë kryesore. Nga bashkëbisedimet që grupi i ekspertëve të jashtëm me grupin e studentëve dhe të diplomuarve të programit master profesional në komunikim publik, u konstatua se studentët kishin pak informacion mbi funksionimin e organeve vendimmarrëse kolegjiale si dhe nuk ishin të informuar për mënyrën e përfaqësimit të tyre në këto organe.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Nga analiza e planit mësimor duket një ngarkesë e pabalancuar në dy simestret e vitit akademik. Është e rëndësishme që gjatë përmirësimit të programit në të ardhmen të mbahet parasysh ky fakt dhe ndarja e krediteve në dy semestret të bëhet duke marrë parasysh ngarkesën e studentëve. Nga ana tjetër këto përmirësime duhet të reflektohen edhe në rregulloren e programit të studimit, sidomos mënyra e organizimit të lëndës praktikë profesional dhe tezës. Njohja e studimeve të mëparshme, është rregulluar në kuadrin rregullator të brendshëm. Në këtë pikë është e nevojshme të rritet informimi i studentëve për procedurat dhe procesin.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton	Përmes përfshirjes së studentëve në organet vendimmarrëse të IAL-së, mund të garantohet edhe kontributi i tyre në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Mbetet i rëndësishëm zgjerimi i përfshirjes së studentëve në organe kolegjiale në të gjitha nivelet.

sugjerimet e kontributin e tyre në to.									
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Anketimet periodike që realizohen nën kordinimin e NJSBC-së u mundëson studentëve dhënien e mendimit mbi çështje që lidhen me ecurinëe tyre akademike, cilësinë e mësimdhënies dhe barazinë në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Neni 6 i rregullores së NJSBC-së parashikon mënyrën bërjes së vlerësimit për procesin mësimor.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Informimi i studentëve dhe ofrimi i shërbimeve bëhet e i mundur nga strukturat administrative dhe akademike, pjesë e strukturës së përgjithshme të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Një rol të rëndësishëm duket se luan drejtorja përkatëse për komunikimin e cila bën të mundur menaxhimin e hapësirave dhe kanalave të informimit për studentët dhe publikun. Menaxhimi i faqes zyrtare në internet, përditësimi i vazhdueshëm dhe plotësimi me informacione dhe njoftime që i vijnë në ndihmë studentëve, menaxhimi dhe përditësimi i kanalave zyrtare në rrjetet sociale bëjnë të mundur informimin e studentëve në mënyrë të plotë dhe cilësore. Faqja zyrtare ka rubrika të posaçme dhe materiale udhëzuese që ndihmojnë studentët të aksesojnë shërbime të tilla si bilbiloteka apo sistemi i menaxhimit. Njësitë e tjera si sekretaria mësimore dhe njësia përgjegjëse për planfikimin e karrierës plotësojnë kuadrin e strukturave të posaçme për informimin e dhe ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Informimi dhe këshillimi i studentëve bëhet përmes Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës, e cila ofron shërbime këshillimore dhe orientuese për studentët. Kjo zyrë mban kontakte të vazhdueshme me studentët dhe me institucione partnere në funksionin të orientimit dhe mbështetjes së studentëve në integrimin e tyre me tregun e punës. Pjesë e zinxhirit të organizmave informuese dhe këshilluese për studentët është edhe Këshilli Studentor, i cili përfaqëson zërin studentor në organet vendimmarrëse të universitetit.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në	Zyra e Këshillimit dhe Karrierës si strukturë përgjegjëse për mbështetjen e studentëve në planfikimin e karrierës ofron mbështetje në gjetjen dhe organizimin e praktikave mësimore për studentët. Kjo zyrë ka për detyrë të orientojë studentët dhe të krijojë kontaktet ne nevojshme me institucione apo kompani të ndryshme që mund të ofrojnë mundësi






<p>mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>praktike për studentët. Megjithatë duke patur parasysh numrin e lartë të studentëve dhe mënyrë e përqëndruar të funksionimit të zyrës, duket e vështirë që kjo strukturë të ofrojë mbështetje për studentët e secilit program studimi, me specifikat dhe dallimet që ka. Ndaj në këtë pikë, <i>sugjerohet zgjerimi i strukturës së këshillimit të karrierës edhe në nivel të njësisë bazë, ku një anëtar i personelit mund të luajë rolin e këshilltarit të karrierës për studentë dhe të garantojë koordinimin mes zyrës përgjegjëse dhe studentëve të programit po të departamentit.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Plani i aktiviteteve të zyrës së këshillimit të karrierës vërteton një sistem ndjekjeje dhe përkujdesje për studentët edhe pas periudhës së diplomimit. Përfaqëuesit e zyrës përmes organizimit të takimeve me të diplomuar nga programet e studimit bëjnë të mundur mbajtjen e lidhjeve të këtyre të fundit me institucionin dhe sigurimin e të dhënave të përditësuar për gendjen integritet të tyre në tregun e punës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	



<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UAMD ka miratuar një “Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë”, e cila i përmbahet Standardeve Europiane kryesore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Kjo rregullore specifikon në mënyrë të detajuar standardet mbi politikën për sigurimin e cilësisë; hartimin dhe miratimin e programeve; të nxënit, mësimdhënia dhe vlerësimi me në qendër studentin; pranimi i studentëve, progresi, njohja e krediteve dhe diplomimi i tyre; personeli akademik; burimet e të nxënit dhe mbështetja për studentin.</p>

	<p>Neni 21 i kësaj rregulloreje përcakton qartë strukturat përgjegjëse për sigurimin e standardeve të cilësisë, të cilat në nivel Institucional janë: (i) Senati Akademik; (ii) Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC); (iii) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSC)/Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL); (iv) Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC).</p> <p>Ndërsa në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: (i) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti); (ii) Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.); (iii) Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.).”</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UAMD ka miratuar dhe ka në funksionim Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila ka si detyrë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Përgatitjen e raporteve periodike (3-mujorë, 6-mujorë dhe vjetorë) të vetëvlerësimit të cilët i propozohen Senatit Akademik për miratim nga KPGSC. Rritjen e ndërgjegjësimit të brendshëm mbi çështjet e cilësisë. Evidentimin pranë fakulteteve dhe njësive të tjera pranë UAMD-së pikat e tyre të forta dhe të dobëta, së bashku me sugjerimet e marra për zhvillimin e veprimtarive të tyre për të përmirësuar më tej pikat e forta dhe për të minimizuar në mënyrë të vazhdueshme dobësitë. NjBSC në nivel institucional realizon misionin e saj në bashkëveprim me NjBSC-në në nivel Fakulteti. Merr masa parapërgatitore për vlerësimin e jashtëm të cilësisë. Angazhohet në trajnimin dhe zhvillimin profesional për çështjet e “cilësisë”, si dhe kompetencave të tjera funksionale të stafit akademik dhe atij administrativ <p>Detyrat e NJSBC parashikohen në “Rregulloren për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë”</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UAMD ka kaluar akreditimin institucional me Vendimin e Bordit Nr. 10 datë 07.04.2017 me një akreditim akademik për 4 vite. Aktualisht ka në proces akreditimi disa programeve mësimore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së</p>	<p>Në UAMD, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë (KPGSC) mbikqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm. Ky Komisioni i Përhershëm është përgjegjës dhe struktura që e djek në vazhdimësi dhe e garanton përmirësimin e cilësisë në UAMD.</p>






cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Këto kompetenca parashikohen në “Rregulloren për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë”, Neni 2 i saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	<p>UAMD ka një njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit. Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë përmbledh detyrat e NjSBC pranë çdo fakulteti si edhe rolin e kordinatorit të programit të studimit në funksion ruajtjes së cilësisë. Koordinatori i programit të studimit në UAMD krahas detyrave të tjera kujdeset për garantimin e suksesit të studentëve në universitet. Koordinatori i programit ka edhe detyrë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Raporton pranë dekanit dhe NjBSC-së mbi cilësinë dhe standardet e programit që mbikëqyr; ▪ Përgatit raporte vjetore, dhe kur kërkohet nga NjBSC-ja gjatë një procesi akreditimi, mbi programin që mbikëqyr, duke u bazuar në formatet e përcaktuara nga NjBSC-ja; ▪ Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme studimin e tregut mbi programin që mbikëqyr; ▪ Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme dosjen e programit që mbikëqyr; ▪ Në bashkëpunim me kordinatorin e departamentit për kërkimin shkencor, përgatit një raport vjetor, dhe kur kërkohet nga NjBSC-ja gjatë një procesi akreditimi, mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	<p>UAMD, për mbikëqyrjes e herë pas hershme të programeve mësimore të ciklit të dytë, përdor procese formale shqyrtimi dhe miratimi. Procesi i vlerësimit të brendshëm udhëhiqet nga kordinatorët e programit mësimor.</p> <p>Departamenti i Shkencave Politike dhe Fakulteti i Shkencave Politike Juridike përdorin metoda të ndryshme si, kontrollet nga drejtuesit e Fakultetit, analizat dhe diskutimet në mbledhje të departamentit dhe fakultetit, anketimet e studentëve dhe aktorëve të tjerë, matjet e performancës së pedagogëve me anën e disa kriterëve të standartizuara më parë; etj.</p>

	<p>Këto forma vlerësimi parashikohen në nenin 2 të “Rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë:.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Sipas “Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë” (Neni 15) të dhënat kryesore statistikore përfshijnë: (i) Ecurinë e studentëve dhe nivelet e suksesit; (ii) mundësitë e punësimit të të diplomuarve; (iii) profilin e popullatës studentore; (iv) raportin pedagog/studentë; (v) plotësimi i kërkesave të studentëve me programet e tyre; (vi) efektivitetin e pedagogëve; (vii) koston e burimeve të mësimnxënies dhe disponueshmërinë e tyre; (viii) monitorimin e situatës së punësimit të të diplomuarve; (ix) nivelin e largimit/transferimit të studentëve; (x) numrin e stafit dhe studentëve që pranohen dhe largohen.</p> <p>Sipas së njëjtës rregullore, Treguesit Kyç të Performacës janë: (i) Ruajtja e nivelit të regjistrimeve; (ii) nivelet e kalueshmërisë; (iii) nivelet e diplomimit; (iv) diversiteti i profileve studentore, etj.</p> <p>Të dhënat e mbledhura në nivel fakulteti i dërgohen NjBSC-së në çdo fillim viti akademik. Më tej ajo ka për detyrë të japë mendim në formën e sugjerimeve dhe masave korrigjuese. Të dhënat, sugjerimet dhe masat korrigjuese shqyrtohen nga KPGSC-ja, dhe më pas i propozohen Senatit Akademik për miratim.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e marra nga analiza ruhen, arkivohen dhe transmetohen në/nëpërmjet strukturave përkatëse, në lidhje me programet e studimit, për vendimmarrje të mëtejshme, të cilat janë të specifikuar në nenin 16 të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Pas hartimit dhe miratimit të treguesve kyç të performancës dekanët e fakulteteve, në konsultim me stafin akademik të çdo departamenti, përcaktojnë prioritetet e fakulteteve për t’i renditur me prioritetet e universitetit.</p> <p>Praktika e ndjekur më tej rezulton të jetë e dobishme për ruajtjen dhe zhvillimin e cilësisë së brendshme. NjBSC bën një rishikim vjetor të veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore, i cili përfshin numrin e studentëve që diplomohen, numrin e publikimeve dhe kërkimeve shkencore, mënyrën sesi funksionon sistemi i sigurimit të cilësisë, si dhe çdo ankesë për funksionimin e sistemit përdoret si tregues i performacës.</p> <p>Përmes kësaj praktike, NjBSC-në, KPGSC dhe Senati Akademik shqyrtojnë fushat problematike dhe vendosin për alokimit e burimeve dhe zhvillimeve të ardhshme.</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Raportet analitike dhe vlerësuese përmbajnë të dhëna për ecurinë e deritanishme, realizimin e pritshmërive në raport me objektivat, parashikimet për periudhat e ardhshme, si edhe adresimin e mangësive për përmirësim të mëtejshme të cilësisë.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Politike dhe Fakulteti i Shkencave Politike Juridike kanë hartuar një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe kjo analizë përfshihet në analizat e mëtejshme në rang fakulteti dhe universiteti. Ndërkohë, GVJ krahas dokumentave të tjerë u njoh edhe formatet e pyetësorëve me studentët dhe stafin të zhvilluar për kontrollin periodik të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në matjen e cilësisë së mësimdhënies përdoren metoda dhe instrumenta specifike, të cilat i përshtaten profilit të studimit në mënyrë që të sigurohet efikasiteti i veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve.</p> <p>Neni 6 “Sigurimi i cilësisë” i “Rregullores për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë” thekson se vlerësimi i cilësisë sigurohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetësit të studentit, i cili propozohet nga KPGSC dhe miratohet nga Senati Akademik; • Vlerësimit të përgjegjës të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë, duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore; • Vlerësimit të drejtuesit të njësisë kryesore për stafin që ai drejton. Ky pyetësor zhvillohet në fund të semestrit të dytë, brenda muajit Qershor, dhe së bashku me vlerësimin e studentëve i vihet në dispozicion Rektoratit.
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e</p>	<p>Në kuadër të pëmirësimit të cilësisë përdoren metoda të drejtpërdrejta, të cilat i referohen nenit 6 të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe manualit për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike. Gjithashtu mbështetur dhe në Kreun VII të Statutit të Ri të UAMD dhe në nenin 29 të Statutit të vjetër.</p> <p>Për të vëzhguar mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit të studimit në universitet realizohen:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Pyetësorë të studentëve, të cilët vlerësojnë institucionin; b) Pyetësorë të stafit akademik, i cili vlerëson institucionin; c) Pyetësorë të stafit administrativ, i cili vlerëson institucionin.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al

55

<p>arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nisur në rregulloret përkatëse, por edhe nga takimi që u zhvillua me përfaqësuesit e NJSBC dhe drejtejtuesit e Njësisë Bazë dhe Koordinatorit të programit, u theksua fakti se cilësia e shërbimeve të ofruara nga institucioni për studentët matet kryesisht nga hartimi dhe zbatimi i politikave për shërbimet inovative në universitet, infrastrukturës, faciliteteve, bibliotekës, shërbimeve nga ana e sekretarive mësimore, teknologjisë së informacionit etj. Ky vlerësim realizohet një herë në vit, zakonisht brenda muajit Qershor të çdo viti akademik.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Metodat e tërthorta si sondazhe, intervista etj., janë një formë e përdorur gjerësisht brenda UAMD, qofshin këto me studentë aktualë, me të diplomuar, me staf akademik dhe administrativ, por edhe me aktorë të ndryshëm të tregut. Kjo praktikë parashikohet 6 dhe 15 të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, si edhe në nenin 20 të Rregullores së re të UAMD, nenet 68 e 69.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat janë specifikuar në manualin për sistemin e brendshëm për siguin e cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike dhe në nenet 5 dhe 6 të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Ndërkohë, vlerësimi i brendshëm bëhet nga struktura përkatëse sipas përcaktimit në “Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë”. Neni 2 i kësaj rregulloreje përcakton se në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>1. Senati Akademik; 2. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC); 3. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSC)/Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL);</p>






	<p>4. Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC); Ndërsa në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti) ▪ Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.) ▪ Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.) <p>Organigrama ka të përcaktuar qartë edhe detyrat dhe të drejtat e secilit nga personat në funksionet e mësipërme duke detajuar edhe funksionet për kontrollin e cilësisë.</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete janë të përcaktuara në nenet 9, 10, 11 të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe në nenin 17 të Rregullores së Fakultetit të Shkencave Politike Juridike. Ndërkohë, duhet theksuar se në Njësine bazë të Shkencave Politike u vu re një bashkëpunim i kënaqshëm midis stafit akademik dhe atij ndihmës në shërbim të mbarëvajtjes së programit.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>UAMD respekton integritetin akademik dhe shmang diskrimimin dhe pabarazinë në vlerësim, si për studentët dhe pedagogët.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Gjatë takimit të zhvilluar me GVB, ku pjesëmarrëse ishte edhe një përfaqësuese e industrisë, u vu re se për vlerësimin e programit MP “Komunikim Publik”, Departamenti i Shkencave politike kishte angazhuar edhe aktorë nga tregu, të cilët e njohin nga afër programin dhe produktin që nxjerr ai.</p> <p>Për t’u lavdëruar ishin edhe sugjerimet e ofruara nga studentët e diplomuar, të cilët pohuan se në takimet e organizuara me ALUMNI, kishin propozuar forma të reja praktike profesionale, të cilat departamenti i kishte vlerësuar dhe i kishte marrë parasysh në mënyrën e përzgjedhjes dhe ndërlshjes me institucionet përkatëse.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------






<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nëpërmjet ëeb-it të UAMD, komunikimeve më email, takimeve informuese dhe publikimet në rrjetet sociale studentët informohen periudikisht për organizimin, strategjitë, politikat, veprimtaritë dhe masat e marra për ecurinë dhe përmirësimin e cilësisë.</p> <p>UAMD a një rregullore specifike për sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Nënfaqet në Internet të UAMD me informacione janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. ëëë.dimtv-project.al 2. Lista e Prioriteteve Kombëtare për thirrje për projekte Erasmus+ 2017 3. https://eacea.ec.europa.eu/erasmus-plus/funding/capacity-building-in-field-higher-education2017_en 4. Vendim i Bordit të Akreditimit, Nr. 10, datë 07/04/2017 “Për Akreditimin e parë të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës https://www.ascal.al/index.php?option=com_k2&view=item&layout=item&id=97&Itemid=698&lang=sq 5. https://www.facebook.com/uamdoofficial/ 6. https://www.facebook.com/AlumniUAMD/ 7. https://www.facebook.com/FTIUAMD/ 8. https://www.facebook.com/multimedia.fti.uamd 9. https://www.facebook.com/dimtval/ 10. https://www.facebook.com/dimtval/ 11. https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/ 12. https://www.youtube.com/channel/UC26J1hWuOri6WKYMo0QnqLg 13. https://www.youtube.com/channel/UCB5JXbriëSaBrQVGOQBVCHE 14. https://www.instagram.com/multimediatvd/ 15. https://www.instagram.com/uamdoofficial/ 16. https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/dokumente
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e studimit iu vihen në dispozicion personelit akademik, edhe publikohen për studentët dhe aktorët e tjerë, duke respektuar etikën akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Brenda faqes zyrtare të tij, UAMD ka përfshirë edhe Programin e transparencës. Ndërkohë, në faqen e Universitetit, në rubrikën shërbime/ dokumenta gjenden informacione mbi rregulloret e institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Politike dhe Fakulteti i Shkencave Politike Juridike angazhohen dhe marrin masa në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime të mëtejshme. Në rastet kur ka problematika, ekziston mundësia për të ndryshuar kushtet, kohën e angazhimit të lektorëve me kohë të plotë ose të pjesëshme.</p> <p>Nga takimi që u zhvillua me Dekanin e fakultetit në mjediset e institucionit, por edhe me përfaqësues të tjerë, u theksua fakti se në momentet që pedagogët merrnin vlerësime nën 40% nga anketat e zhvilluara me studentë, atyre nuk u jepes më e drejta për të dhënë atë lëndë. Në rastet kur vlerësimi ishte nën 70%, atëherë, duke ruajtur kushtet e privatësisë dhe etikës profesionale, pedagogut i jepeshin sugjerime nga drejtuesi i njësisë bazë për të përmirësuar ankesat e dala nga vlerësimi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron</p>	<p>Informacionet e marra nga pyesorët e ndryshëm janë pjesë e raportimeve të ndryshme periodike që bëjnë njësitë kryesore respektive. Raportet për</p>

<p>efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>monitorimin e cilësisë shpërndahen me stafin akademik dhe diskutohen për përmirësim të mëtejshëm të programeve të ndryshme mësimore.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Në mënyrë periodike fakulteti dhe departamenti organizojnë takime informuese për ndryshimet e ndodhura dhe përmirësimet e mëtejshme. Njëkohësisht, personeli është në dispozicion në ditë dhe në orare të ndryshme për studentët. Ndërkohë, UAMD ka ngritur një strukturë organizative funksionale të bazuar në rregulloren e brendshme dhe në statutin e saj. Rregullorja përcakton detyrat funksionale në të gjitha nivelet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Koordinator i programit është përgjegjës për sigurimin e cilësisë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Komunikim Publik” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Në hapjen e programit Master Profesional në Komunikim Publik, UAMD është mbështetur në një studim të detajuar tregu, duke pasur një vizion të qartë mbi mbarëvajtjen e studimeve dhe të karrierës së studentëve.
2. MP në Komunikim Publik plotëson kuadrin formues të studentëve në dy cikle studimi. Ky program pason studimet e ciklit të parë BA në Marrëdhënie Publike.
3. Programi mbështetet në shembuj dhe përvoja të suksesshme ndërkombëtare që ofrojnë studime të ngjashme. UAMD e ka përshtatur atë më së miri me realitetin shqiptar.
4. Stafit akademik i angazhuar në realizimin e programit rezultojnë të ketë ekspertizën e mjaftueshme për të përcjellë tek studentët eksperiencat më bashkëkohore të kësaj fushe. Krahas punës së stafit përgjegjës për realizimin e këtij programi, mbetet për t'u vlerësuar edhe angazhimi i ekspertëve dhe studiuesve të fushës, vendas dhe të huaj, të cilët ndajnë eksperiencat e tyre me studentët.
5. Infrastruktura e UAMD dhe mjediset fizike të kampusit ku zhvillohet mësimi i këtij programi plotëson të gjitha nevojat për realizimin e suksesshëm të tij. Fakulteti i Shkencave Politike Juridike ka hapësirat dhe teknologjinë e duhur për ta zhvilluar edhe më tej këtë program.
6. Për t'u vlerësuar mbetet kënaqësia që studentët e diplomuar kanë për UAMD, të cilët shprehën mirënjohje ndaj mënyrës së si institucioni i kishte ndihmuar për t'u integruar në tregun e punës.
7. Edhe pse nuk ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin mësimor të këtij programi, stafi akademik i angazhuar në të rezultojnë të jetë pjesë e disa projekteve kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, gjë kjo që tregon përditësimin e tyre me tendencat bashkëkohore në fushën e kërkimit.
8. Bashkëpunimi ndërkombëtar mbetet një pikë e fortë në nivel institucional të UAMD. UAMD ka nënshkruar shumë marrëveshje ndër-institucionale, qofshin këto me institucione arsimore, apo edhe aktorë të tregut publik ose privatë, të cilat edhe pse në nivel institucional, shërbejnë për mbarëvajtjen e mirë të programit MP “Komunikim Publik”.
9. Zyra e Karrierës dhe Praktikave dhe aktiviteti i saj mund të vlerësohet si një pikë e fortë për suksesin dhe integrimin e studentëve në tregun e punës. Ajo mban lidhje të drejtpërdrejta me studentët e diplomuar. UAMD ka një strukturë të posaçme ALUMNI, e cila gjatë vitit organizon disa evente me pjesëmarrjen e të diplomuarve.
10. Institucioni ka dy sisteme informatike në funksion të studentëve dhe personelit akademik. Një nga sistemet është “Aula” ndërsa tjetri është sistemi “Pitagora”. Aksesimi i këtyre sistemeve është i mundur edhe në distancë. Studentët kanë mundësi të logohen nga çdo vend duke marrë shërbimin e kërkuar.
11. Departamenti ka krijuar një praktikë pozitive në organizimin e leksioneve të hapura me akademikë dhe profesionistë të tregut.

12. Prania e bibliotekës online. Institucioni u garanton studentëve akses në librarinë elektronike nëpërmjet abonimit në platforma si EBSCO. Biblioteka ofron akses edhe në disa databaza të tjera.

Pika të dobëta



1. Nga verifikimi i bërë në bibliotekën fizike, vihet re se literatura në gjuhën shqipe nuk është e mjaftueshme në fushën e komunikimit masiv dhe komunikimit publik. Nevojitet të garantohen titujt e nevojshëm në gjuhën e programit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi marrin informacionin e nevojshëm. Në veçanti duhet të shtohen numri i botimeve që shërbejnë si literaturë bazë për lëndët e formimit të përgjithshëm.
2. Zhvillimi i praktikës mësimore gjatë muajve të verës me parakusht shlyerjen e provimeve të lëndëve të tjera zgjat në mënyrë të panevojshme kohën e studimeve.
3. Ndarja jo proporcionale e ngarkesës mësimore midis dy semestrave. Njësia bazë duhet të marrë masat për një ndarje më të kujdesshme, duke lehtësuar punën dhe ngarkesën e studentëve.

Rekomandime

1. Nisur nga madhësia e UAMD, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, pavarësisht punës së lavdërueshme që bën, rezulton të jetë e pamjaftueshme për nevojat e të gjithë studentëve dhe programeve të studimit brenda këtij institucioni. Për një bashkërendim më efikas të punëve, sugjerohet që çdo njësi bazë të ketë një këshilltar karriere që të bashkëpunojë me këtë zyrë, gjë që do të lehtësonte procesin e integritit të studentëve në tregun e punës dhe lidhjen e tij me aktorë të ndryshëm të biznesit dhe institucioneve publike e private.
2. Duke qenë se programi është planifikuar të organizohet brenda një viti akademik, të ndarë në dy semestra, sugjerohet që të bëhet një balancim më i mirë i ndarjes së ngarkesës në planin mësimor. Gjithashtu, sugjerohet edhe heqja e parakushteve për marrjen e tezës dhe të lëndës së praktikës.
3. Sugjerohet që në faqen e internetit të krijohet një hapësirë e posaçme për publikimin e raporteve të cilësisë dhe analizat e anketimeve të studentëve.
4. Sugjerohet që në të ardhmen të mundësohet përfshirja e studentëve në projekte që ndihmojnë përmirësimin e imazhit të vetë institucionit. Studentët e programit Master profesional në Komunikim Publik, për nga vetë profili i studimit dhe formimi që marrin mund të japin një kontribut të rëndësishëm pranë drejtorisë së komunikimit të institucionit. Kjo praktikë do të ishte me interes edhe për vetë studentët të cilët duke plotësuar detyrimet e lëndëve të ndryshme mund të ndihmojnë institucionin me projekte dhe ide të vlefshme.
5. Biblioteka në funksion të këtij programi studimi duhet të ketë një hapësirë më të madhe, ku studentët dhe stafi akademik të mund ta shfrytëzojnë atë më mirë në përputhje me misionin dhe domosdoshmërinë e saj.
6. Sugjerohet pasurimi me titujt dhe literaturë të detyrueshme dhe të sugjeruar në lidhje me fushën e komunikimit në përgjithësi, dhe komunikimit publik në veçanti.
7. Sugjerohet miratimi i një politike për trajnimin e vazhdueshëm të stafit, e cila do të ndikonte pozitivisht në rritjen e cilësisë. Po kështu është e nevojshme rritja e rolit të

njësisë kryesore në përcaktimin e nevojave për trajnime specifike të personelit akademik. Nevoja për trajnime të stafit sugjerohet të koordinohet mes njësive kryesore dhe njësive dhe strukturave administrative si Burimet Njerëzore dhe NJSBC.

8. Roli i zyrës së Këshillimit të Karrierës duhet të bëhet më i njohur për studentët. Në këtë pikë do ishte e dobishme që njësia bazë të merrte më shumë rol në këshillimin e karrierës. Për të bashkërenduar më mirë punën me zyrën përkatëse dhe për t'i ardhur në ndihmë studentëve, caktimi i një këshilltari për karrierën në departament është një hap i këshillueshëm.
9. Përfaqësimi i studentëve sugjerohet të garantohet dhe institucionalizohet edhe në nivel të organeve kolegjiale të njësisë kryesore dhe njësive bazë. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike në nenin 15 ku përcaktohet përbërja e Dekanatit, nuk parashikon përfaqësimin e studentëve.





Strong points

1. In opening the Professional Master in Public Communication program, UAMD has relied on a detailed market study, having a clear vision on the progress of students' studies and careers.
2. The study program Professional Master in Public Communication completes the studies in two study cycles. This program follows the first cycle BA in Public Relations.
3. The program relies on successful international examples and experiences that offer similar studies. UAMD has adapted it a very good way according to the Albanian reality.
4. The academic staff engaged in the implementation of the program turns out to have sufficient expertise to provide students with the most contemporary experiences in this field. In addition to the work of the staff responsible for the implementation of this program, it remains to be appreciated the commitment of experts and researchers in the field, local and foreign, who share their experiences with students.
5. The infrastructure of UAMD and the physical environments of the campus where the teaching of this program takes place meets all the needs for its successful realization. The Faculty of Political and Legal Sciences has the necessary space and technology to further develop this program.
6. The satisfaction that graduate students have for UAMD remains to be appreciated. They expressed gratitude for the way the institution had helped them to integrate into the labor market.
7. Although it has not directly affected the teaching process of this program, the academic staff engaged in it has been part of several research projects at national and international level, which shows their updating with contemporary trends in the field of research.
8. International cooperation remains a strong point at the institutional level of UAMD. UAMD has signed many inter-institutional agreements with educational institutions, or even public or private market actors, which, although at the institutional level, serve for the good progress of the PM program in "Public Communication".
9. Career and Internship Office and its activity can be considered as a strong point for the success and integration of students in the labor market. It maintains direct links with graduate students. UAMD has a special ALUMNI structure, which during the year organizes several events with the participation of graduates.
10. The institution has two computer systems in function of students and academic staff, "Aula" and "Pythagoras". Access to these systems is also possible in distance. Students have the opportunity to log in from any place by receiving the required service.
11. The Department has established a positive practice in organizing open lectures with academicians and market professionals.
12. Presence of online library. The institution guarantees students access to the electronic library through subscription to platforms such as EBSCO. The library also offers access to several other databases.

Weaknesses

1. From the verification made in the traditional library, it is noticed that the literature in the Albanian language is not sufficient in the field of mass communication and public





communication. It is necessary to guarantee the necessary titles in the program language, so that students have the opportunity to receive the necessary information. In particular, the number of publications that serve as basic literature for general education subjects should be increased:

2. The development of teaching practice during the summer months with the precondition of passing the examinations of other subjects unnecessarily prolongs the study time.
3. Disproportionate division of workload between two semesters. The Department should take measures for a more careful division, facilitating the work and workload of students.

Recommendations

1. Given the size of UAMD, the Student Care Office, despite the worthy work it does, seems to be insufficient for the needs of all students and study programs within this institution. For a more efficient job coordination, it is suggested that each core unit have a career counselor to collaborate with this office, which would facilitate the process of integrating students into the job market and linking it to different business actors and public and private institutions.
2. Since the program is planned to be organized within an academic year, divided into two semesters, it is suggested to make a better balance of the division of workload in the curriculum. It is also suggested that the preconditions for taking the thesis and the subject of practice to be removed.
3. It is suggested that a special space should be created on the website for the publication of quality reports and analysis of student surveys..
4. It is suggested that in the future to involve students in projects that help improving the image of the institution itself. Students of the Professional Master program in Public Communication, in terms of the study profile and the training they receive, can make an important contribution to the communication office (PR office) of the institution. This practice would be of interest to the students themselves who by fulfilling the obligations of different subjects can help the institution with valuable projects and ideas.
5. The library in the function of this study program should have a larger space, where students and academic staff can use it in a better way in accordance with its mission and necessity.
6. It is suggested to enrich with obligatory and suggested titles and literature related to the field of communication in general, and public communication in particular.
7. It is suggested to adopt a policy for continuous staff training, which would have a positive impact on increasing quality. It is also necessary to increase the role of the main unit (Faculty) in determining the needs for specific training of academic staff. The need for staff training is suggested to be coordinated between key and administrative units and structures such as Human Resources, Internal Quality Assurance Committee, etc..
8. The role of the Career Counseling Office should become more familiar to students. At this point it would be helpful for the department to play a greater role in career counseling. To better coordinate work with the relevant office and to help students, appointing a career counselor to the department is a advisable step..



9. Student representation is suggested to be guaranteed and institutionalized at the level of the collegial bodies of the main unit and the basic units. The Regulation of the Faculty of Political and Legal Sciences in Article 15 which defines the composition of the Dean's Office does not provide for the representation of students.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

